



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

MIRATOHET

KRYETARI BASHKISË

GLEDDIAN LLATJA

DETYRË PROJEKTIMI

“Rikonstruksioni i Shkollës "Vasil Kamami"”

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	2
1.1	Institucioni përfitues	2
1.2	Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje	2
1.3	Baza ligjore	2
1.4	Qëllimi i projektit të investimit	3
1.5	Objektivat e projektit të investimit.....	3
2.	PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT	3
2.1	Qëllimi	3
2.2	Objektivat.....	4
2.3	Përshkrim i përgjithshëm	4
2.3.1	Pozicionimi i parcelës që zhvillohet	4
2.3.2	Gjendja faktike	5
2.3.3	Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor	9
2.3.4	Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv	11
2.3.5	Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve	14
2.3.6	Rrjeti elektrik, telefonik dhe kompjuterik	15
2.3.7	Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë	16
2.3.8	Sistemi i mbrojtjes atmosferike.....	17
2.3.9	Sistemi ngrohës dhe i ventilimit.....	17
2.3.10	Sistemi i mbrojtjes nga zjarrit (MNZ).....	18
2.3.11	Raporti dhe auditimi i efencës energjitike.....	18
2.3.12	Kërkesat teknike kundrejt shërbimit të VNM	19
3.	HARTIMI I PREVENTIVIT	19
4.	STANDARDET	20
5.	REALIZIMI I PROJEKTIT	20
	<i>Rekomandime për projektuesin</i>	21
	<i>Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar.....</i>	21
6.	KOHËZGJATJA E KRYERJES SË SHËRBIMIT.....	22
7.	RAPORTIMI.....	22
8.	PARAQITJA E VIZATIMEVE.....	23
9.	PREVENTIVI.....	24
10.	INVESTIMI THEMELOR.....	24

1. HYRJE

1.1 Institucioni përfitues

Institucioni përfitues i shërbimit në fushën e projektimit është Bashkia Elbasan. Përfituesi i këtij shërbimi është Institucion Publik.

Misioni i këtij institucioni është:

- Të sigurojë një shërbim arsimor sa më të mirë, të drejtë, transparent dhe gjithëpërfshirës për çdo nxënës, të shkollës së mesme të përgjithshme "Vasil Kamami".

Vizioni "Elbasani, qyteti i fëmijëve".

Bashkia Elbasan zhvillon aktivitetin bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë në tërësi dhe legjislacionin e posaçëm për institucionet e arsimit parauniversitar në veçanti.

Përfituesit parësorë janë komuniteti i nxënësve që ndjekin arsimin në këtë shkollë, si dhe stafi pedagogjik i nivelit arsimor të kësaj shkolle.

Përfituesit e tërthortë janë prindërit e nxënësve që ndjekin arsimin në këtë shkollë si dhe komuniteti i banorëve të zonës përreth, si rritje e cilësisë së infrastrukturës së zonës urbane, por dhe mundësi për zgjedhje si shkollë me standarde për brezat e rinj pasardhës.

Nga realizimi i tij do të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë 147 nxënës, prej të cilëve 3 fëmijë me aftësi të kufizuar dhe 13 fëmijë egjiptianë, dhe 19 mësues, si dhe në mënyrë të tërthortë 294 prindër e komuniteti përreth.

1.2 Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje

Sipas vlerësimit teknik, shkolla ka nevojë për Rikonstruksion Tipi A. Punimet kryesore të rikonstruksionit të ndërtesës kanë të bëjnë me: rinovim total të pllakave të dyshemeve pasi janë të vjetra që nga viti i ndërtimit; rinovim të suvatimeve të brendshme dhe jashtme të amortizuara nga lagështia; lysterje totale brenda dhe jashtë me bojë hidroplastike; rinovim total të dritareve, dyerve të brendshme dhe derës së jashtme të shkollës; rinovim të sistemit elektrik të shkollës, rinovim të fuqisë së rrjetit, rinovim të prizave dhe çelësave; rinovimin e shtresave të hidroizolimeve të çatisë; riparim të ulluqeve të çatisë; rinovim të dyshemesë të palestrës së brendshme si dhe disa riparime të suvave dhe lysterje të mureve; ndërtim të një terreni sportiv jashtë sipas standardeve.

1.3 Baza ligjore

Bazuar në statusin ligjor të institucionit, ky shërbim në fushën e projektimit duhet të përmbushë kërkesat dhe të marrë në konsideratë referencat si vijon:

1. Ligj nr. 107, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
2. Ligj nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë";
3. Ligj nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
4. Ligj nr. 116/2016, "Për performancën e energjisë në ndërtesa";
5. VKM nr. 408, "Rregulloren e Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar;
6. VKM nr.1503, datë 19.11.2008 "Për miratimin e Rregullores "Për shfrytëzimin e hapsirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar";

7. VKM nr. 319, datë 12.04.2017, "Standardet për projektimit e shkollave";
8. VKM nr. 98, datë 06.02.2013, "Për miratimin e listës së standarteve të harmonizuara shqiptare";
9. VKM nr. 68, datë 15.02.2001, "Për miratimin e standardeve dhe kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit";
10. "Rregullore për formatin e auditimit energjitik dhe pagesën e audituesit energjitik", miratuar me Urdhër nr. 5, datë 12.01.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë;
11. Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore, normat dhe standardet, miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
12. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Elbasan, miratuar me Vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016, i rishikuar;
13. Manuallet, standardet dhe kushtet teknike shtetërore dhe evropiane normat ISO të projektimit të objekteve arsimore;

1.4 Qëllimi i projektit të investimit

Qëllimi i rikonstruksionit është "Të përmirësohet infrastruktura arsimore në Elbasan nëpërmjet ndërhyrjes infrastrukturore, si bazë për aplikimin e kushteve ndërtimore që sigurojnë standarde kombëtare për nxënësit dhe mësuesit, familjen dhe komunitetin, respektimin e të drejtave dhe përgatitjen e duhur të brezave të rinj të arsimuar".

1.5 Objektivat e projektit të investimit

Objektivi kryesor i këtij projekti është të sigurojë ambiente të projektuara dhe të përshtatura në përputhje me kërkesat dhe nevojat e veprimtarisë së arsimit të mesëm të përgjithshëm, në respektim të standardeve bashkëkohore infrastrukturore dhe çdo akti juridik, normativ, apo standard në fushën e projektimit të ndërtesave arsimore në Republikën e Shqipërisë.

Objektivat specifikë të këtij projekti investimi përmbledhen në vazhdim:

- Përshtatshmëria funksionale e mjediseve dhe zonimi hapësinor i tyre, në përputhje me kërkesat dhe standardet infrastrukturore për objektet arsimore parauniversitare dhe veprimtarinë institucionale të shkollës së mesme së përgjithshme.
- Plotësimi i mjediseve me sisteme, pajisje, rrjete dhe materiale ndërtimore bashkëkohore.
- Përmeshja e kriterëve infrastrukturore për efikasitetin energjitik, komoditetin termoakustik, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat higjieno - sanitare dhe përshtatjen e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara.
- Sistemimi i mjediseve të jashtme në përputhje me kërkesat për mjedise rekreative, kërkesat drenazhimit të ujërave të shiut, ato për mbrojtjen e mjedisit dhe kriteret për orientimin e fluksit të nxënësve dhe mësuesve të shkollës.

2. PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT

2.1 Qëllimi

Detyra e Projektimit ka për qëllim parashtrimin e të dhënave thelbësore, njohëse, kërkesave dhe nevojave specifike të institucionit përfitues, në cilësinë e Porositësit, kundrejt shërbimit të kërkuar, si dhe orientimet mbi problematikën aktuale të shtruar për zgjidhje, mbi bazën e të cilave, grupi i

projektimit, do të hartojë projektin për “Rikonstruksionin e shkollës së mesme të përgjithshme "Vasil Kamami"”.

2.2 Objektivat

Detyra e projektimit ka këto objektiva:

1. Të prezantojë grupin e projektimit me vendndodhjen, infrastrukturën dhe problematikën e gjendjes faktike të objektit që i nënshtrohet ndërhyrjes.
2. Të përshkruajë kërkesat sasiore dhe cilësore kundrejt shërbimit të porositur.
3. Të evidentojë kërkesat profesionale kundrejt grupit të projektimit.
4. Të shtjellojë formën, mënyrën dhe afatet e raportimit të materialeve pranë Porositësit.

2.3 Përshkrim i përgjithshëm

2.3.1 Pozicionimi i parcelës që zhvillohet

Parcela, në të cilën ndodhet objekti i cili i nënshtrohet ndërhyrjes, së parashikuar nëpërmjet kësaj detyre projektimi, ndodhet pranë qendrës së qytetit të Elbasanit, rreth 580 m nga Sheshi "Gensher", dhe ndodhet në rrugën "Rinia", pranë fushave të Sportit të vjetër, në parcelën kadastrale me nr. pasurie 11/161, në zonën kadastrale 8522. Topografia e zonës është e rrafshët.



Figura 1. Foto e fasadës kryesore të shkollës

Detyrë Projektimi - Rikonstruksioni i Shkollës "Vasil Kamami"




Figura 2. Pozicioni i objektit në hartë kadastrale - plan rilevimi

2.3.2 Gjendja faktike

Analiza e gjendjes faktike të parcelës dhe objektit. Analiza e problematikës që sjell nevojën e investimit dhe kërkesave të shtjelluara në vijim.

Shkolla është e ndërtuar në vitin 1958, por nuk cilësohet si objekt me tipare historike. Që nga viti 2006, një pjesë e ambienteve të shkollës i është dhënë një Qendre. Sipërfaqja e territorit është 3135.8 m². Në të ndodhet godina kryesore 3 katëshe, me një sipërfaqe totale 3032.6 m², ku gjurma e objektit është 1262.6 m². Shkolla mbulohet me çati të pjerrët. Godina cilësohet me një kapacitet mbajtës 400 nxënës. Me një numër total prej 18 klasa.

Ndërtesa e shkollës ka strukturë me muraturë mbajtëse me elementë (kolona, mure, trarë, soleta, themele) në gjendje të mirë dhe funksionale.



Figura 3. Foto e portës së shkollës



Figura 4. Foto të palestrës të shkollës

Detyrë Projektimi - Rikonstruksioni i Shkollës "Vasil Kamami"

Shkolla ndodhet buzë një rruge të gjerë, me trotuare në të dyja krahët, me gjerësi 12 m, lehtësisht e aksesueshme nga automjetet dhe këmbësorët. Rrethimi i shkollës bëhet nëpërmjet mureve dhe kangjellave metalike. Pjesa e pasme e shkollës është e parrethuar dhe në kufi të territorit të shkollës 9-vjeçare "Ptoleme Xhuvani". Hyrja dhe aksesimi në shkollë bëhet nëpërmjet një porte lehtësisht dhe nga personat me aftësi të kufizuar.

Shkolla, aktualisht ka hapësira dhe terrene të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha nevojat e saj për një proces mësimdhënie të mirë. Sipërfaqja e klasave dhe distancat/këndet e fushës së shikimit janë sipas standardeve. Mungon ndriçimi i oborrit dhe pjesërisht drejtimi i dritës natyrore në ambientet e brendshme. Klasat që ndodhen nga perëndimi, kanë dritë natyrore të mjaftueshme, por klasat nga lindja hijëzohen nga shkolla 9-vjeçare dhe për pasojë ndriçimi natyral nuk është aq i fortë.

Shkolla ka sallë mësuesi, drejtori, sekretari, oficer sigurie, zyrë për punonjës social, laborator TIK, SMARTLAB, kimi, biologji, matematikë. Mungon një sallë e dedikuar për aktivitete shumëpërdorimshe, ku aktualisht përdoret palestra.

Zona sportive jashtë ka një fushë të përbashkët për volejball, basketboll, futboll.



Figura 5-10. Foto të korridorit hollit dhe shkallëve të shkollës



Figura 11-13. Foto të deryve të brendshme dhe dritareve të shkollës



Figura 14-16. Foto të mureve dhe suvasë së brendshme të shkollës

Godina nuk ka nevojë për izolim akustik, pasi muret janë shumë të trasha dhe nuk e përcjellin tingullin. Dritaret janë izoluese të këqija, por zona ku ndodhet shkolla është shumë e qetë dhe nuk ka ndotje akustike.

Pajisjet sanitare janë rinovuar në 2020 dhe janë në gjendje të mirë. Kanë nevojë vetëm për riparime apo ndërrime rubinetësh.



Figura 17-18. Foto të nyjeve higjeno-sanitare të shkollës



Figura 19-20. Foto të rrjetit elektrik të shkollës



Figura 21. Foto të muzeut të shkollës



Figura 22-24. Foto të laboratorit TIK të shkollës

Kërkesat teknike planimetriko – kompozicionale dhe infrastrukturore

Hartimi i projekteve specifike, të shtjelluar në vijim, duhet të mbështetet në studimet e thelluara të gjendjes faktike. Çdo dokument teknik që disponohet nga institucioni në shërbim të procesit të projektimit do t'i vendoset në dispozicion grupit të projektimit. Grupi i projektimit duhet të hartojë projektin mbështetur në konstruksionin e ndërtesës ekzistuese, pa anashkaluar kriteret për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e efikasitetit energjetic.

2.3.3 Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor

Me qëllim rritjen e efikasitetit energjetic të godinës projekti duhet të parashikojë veshjen termoizoluese të të gjithë fasadës veshëse të jashtme të godinës. Projekti arkitekturor duhet të mbajë në konsideratë përshtatjen e objektit për personat me aftësi të kufizuara të paktën për katin përdehe, referuar kategorizimeve të kufizimeve të ndryshme. Materialet e propozuara për të gjithë elementët ndarës dhe veshës, termoizolues, hidroizolues etj., duhet të jenë bashkëkohorë, të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe të shmangin elementët e rrezikshmërisë. Rëndësi duhet t'i kushtohet akustikës së ambienteve, izolimit nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës.

Gjatë të gjithë procesit të projektimit është e rëndësishme që të bashkëpunohet ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, pasi projekti arkitekturor duhet të reflektojë kërkesat e projektit strukturor, kërkesat e projekteve të sistemeve teknike, kërkesat e aspekteve arkitekturore të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat për efikasitetin energjetic, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe çdo kërkesë tjetër, të gjykuar si të nevojshme nga specialistët e përfshirë.

Stili arkitekturor

Stili arkitekturor duhet të respektojë funksionin e objektit si institucion publik, duke pasqyruar tendencat, frymën, teknikat dhe teknologjitë bashkëkohore. Stili i konceptimit të interiereve duhet të përputhet me funksionin e objektit. Ngjyra, estetika, stili dhe materialet e përdorur duhet të ndjekin të njëjtën linjë konceptuale, duke reflektuar edhe tendencat e kohës.

Rikonstruksion i plotë i objektit në përputhje me Standardin e Projektimit të Shkollave dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 12.04.2017, "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave", si dhe duke respektuar legjislacionin në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, si dhe rregulloret e zbatimit të tij, në fuqi, distancat nga objekti ekzistues, distancat nga kufiri i pronës, ose distancat ekzistuese përsa kohë nuk ndryshon volumi i ndërtesës, si dhe distancat nga aksi i rrugës në përfundim duke krijuar kështu hapësirat e nevojshme për lëvizjen e këmbësorëve, makinave, etj.

Godina do të jetë ekzistuese 3 kate, duke përmirësuar kushtet sipas standardeve për ambientet e mësimdhënies, administratës, higjienës-sanitare, rekreacionit dhe logjistikës.

- Do të ribëhet hidroizolimi i çatisë;
- Do të vendosen të reja ulluket vertikale dhe sistemimi i ujrave të shiut, duke u maskuar në fasadë;
- Do të prishen të gjitha suvatimet brenda dhe do të ribëhen të reja, me suva 0.1;
- Do të prishen të gjitha shtresat e pllakave dhe do të bëhet shtrimi i tyre me pllaka gres porcelanate; me cilësi të parë, të parrëshqitshme;
- Shkallët do të rehabilitohen me veshje mermeri dhe rikonceptim të parapetit, duke përmirësuar dhe harmonizuar pjesën funksionale, pa rrezikshmëri në lëvizje apo rrëshqitje, si dhe me sinjalistikë identifikuese lehtësisht e dallueshme nga ana vizuale;
- Suvatimi i jashtëm do të bëet me sistem kapote dhe me grafiato 01, lyer me boje hidroplastike, ose zgjedhje të tjera arkitektonike me fasadë të ventuiluar apo më inovative, në harmoni me trajtimin estetik të interierit dhe eksterierit sipas standardeve për eficientësi dhe energjisë.
- Dritaret do të kenë davancal mermeri me frezim për puthitjen e plotë të vetratave në konture për hidroizolim të plotë me ambientin e jashtë;
- Dritaret dhe dyert që janë në kontakt me ambientin e jashtëm do të jenë prej duralumini, dopio xham. Xhami që është në kontakt me ambientin e jashtëm duhet të jetë termik dhe me transparencë;
- Fasada e shkollës, të jetë e tillë që të mirëmbahet lehtë, të evitohen sipërfaqet e mëdha të xhamit atje ku është e mundur, kurse ngjyrat e fasadës të jenë të bukura, në mënyrë që objekti të bëhet më atraktive për nxënësit. Fasadat duhet të jenë të veshura me kapotë termike, apo zgjedhje të tjera më të avancuara për izolim termik dhe antizjarr. Konsulenti duhet të përcaktojë gjithashtu vendndodhjen e tabelës me emrin e shkollës.
- Dyert e jashtëm që janë në katin përdhe do të jenë dyer të izoluara dhe rezistente ndaj goditjeve apo dëmtimeve në rast ushtrimi force;
- Dritaret e katit përdhe do të jenë me elementë mbrojtës metalike (psh. kangjella);
- Muret e brendshëm do të lyhen me hidromat, tavanet me hidromat, kurse pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me bojë akrilik me ngjyrë të ndryshme, ose jo nga muret, me bojë antialergjike, gjë e cila do të vendoset nga projektuesi;
- Instalimet elektrike do të behen të reja;
- Në të gjitha banjot do të shtohen kasetat e shkarkimit dhe përbën avantazh zgjidhja arkitektonike për kursimin e konsumit të ujit në mishelatorë dhe shkarkues wc;
- Kushtet higjieno-sanitare për tualetet e vajzave duhet të ofrojnë parametrat për kujdes personal gjatë periudhës së ciklit menstrual (ujë të ngrohtë, shataff, etj);
- E gjithë infrastruktura e internetit, energjisë elektrike, telefonisë, apo shërbime të tjera të nevojshme si rrjeti i kamerave, duhet të jetë i fshehur në mur dhe tavane të varur me kartonxhez, ku të mos shfaqet rrezikshmëri dhe mundësi dëmtimi gjatë përdorimit të ambienteve;
- Është parashikuar dhe sistemi qendror ngrohjes për të gjithë shkollën e palestrën me ambientet ndihmëse;
- Sipas orientimit natyral të ndërtesës të zgjidhet hijëzimi sipas nevojës, apo shtimi i ndriçimit artificial në interier për të plotësuar kapacitetin homogjen të nevojshëm për mësimdhënie;
- Të zgjidhet vendosja e shkallëve të emergjencës dhe kafazi metalik rrethues me një zgjidhje estetike harmonizuese me fasadën;
- Përbën avantazh propozimi i një sistemi teknologjik dhe promjedisor për fasadën dhe sistemimin e jashtëm të terrenit të shkollës (gjelbërim, hijëzim, instalacione harmonike, ritmika, etj).

Kati përdhe

Kati përdhe i cili ka një sipërfaqe 1262.6 m². Shkallët janë të gjera e plotësojnë parametrat për objekte arsimore të këtij karakteri.

Gjithashtu, në këtë kat duhet organizuar aksesit për hyrjen dhe klasa të dedikuara për nxënës, apo persona me aftësi të kufizuara PAK, një higjeno-sanitare edhe për persona me aftësi të kufizuara PAK, klasat, laboratorë, dhomat e zhveshjes, nyjet sanitare për meshkuj-femra, palestra, si dhe ambiente të tjera të nevojshme.




Figura 10. Planimetri e katit përdhe

Kati i parë dhe i dytë




Figura 11. Planimetri e katit të parë dhe të dytë

2.3.4 Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv

Hartimi i projektit konstruktiv duhet të mbajë në konsideratë propozimin e zgjidhjeve më të përshtatshme, referuar konceptit të përgjithshëm arkitekturor dhe funksionit të ambientit.

Materialet, teknikat dhe teknologjitë e propozuara duhet të respektojnë kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në mungesë të tyre projektuesi duhet t'u referohet Eurokodeve aktuale në përdorim.

Projekti konstruktiv duhet të respektojë kërkesat e jetëgjatësisë së projektimit, ngarkesave dhe rregullave të projektimit për sa i përket durabilitetit (Klasa e durabilitetit), në funksion të kushteve të ekspozimit të tij, bazuar në Eurokode.

2.3.4.1 Themelet

Kusht themelor dhe detyrë parësore teknike është verifikimi i themeleve të godinës ekzistuese si dhe përlllogaritja paraprake e aftësisë mbajtëse të tyre. Këtu përfshihet lloji i materialit me të cilin janë realizuar, përmasat, modalitetet e realizimit të tyre.

Në varësi të gjithë këtyre parametrave, të vetive fiziko-mekanike si dhe të thellësisë së tyre, konsulenti duhet të përcaktojë të gjitha mënyrat dhe mundësitë e ndërhyrjes në të në rast se vlerësohet e nevojshme.

2.3.4.2 Çatia

Projektuesi duhet të japë të gjitha detajet për vendosjen e kasetës së shkarkimit dhe ullukët vertikalë si dhe detaje të tjera të domosdoshme për zbatimin e punimeve duke qenë se një pjesë e ujërave të shiut janë të pasistemuar dhe grumbullohen në ambientet e shkollës. Gjithashtu duhet të tregojë, numrin e ulluqeve dhe diametrat e tyre sipas normave në fuqi. Për sasitë e reshjeve do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik.

2.3.4.3 Soletat

Është detyrë e konsulentit, kontrolli dhe verifikimi teknik i soletave ekzistuese të objektit, në mënyrë që të parashikohet rikonstruksioni i tyre sidomos në rastet kur ka probleme, të lidhura me degradimin e tyre dhe me uljen e aftësive mbajtëse.

Ky lloj kontrolli është akoma më i domosdoshëm në rastin e tavanit të varur në katin e parë i cili është pjesërisht i shkatërruar dhe në disa klasa për arsye sigurie nuk zhvillohet mësim.

2.3.4.4 Muret

Konsulenti do të japë të gjitha detajet e përforcimit të muraturës mbajtëse në rastin kur ajo paraqitet me probleme.

2.3.4.5 Suvatimet

Objekti i rikonstruktuar duhet të suvatohet nga brenda dhe jashtë. Në pjesët e dëmtuara, suvatimet e mureve dhe tavaneve do të kryhen në të gjithë sipërfaqen përkatëse duke ruajtur shtresën e parë ekzistuese ku të mundet në mure, kurse tavanet të pastrohen dhe të risuvatohen. Të gjitha shtresat e tjera në rast se janë të dëmtuara do të hiqen pa dëmtuar muret.

Përsa i përket suvatimeve të jashtme do të jenë në varësi të llojit të ndërhyrjes që parashikon projekti, nëse do të restaurohet sipërfaqja ekzistuese, ose do të rishikohet e gjitha sipas konceptit të ri që kërkon fasada duke marrë në konsideratë dhe kushtet për efikasitetin e energjisë në ndërtesa.

2.3.4.6 Lyerja e mureve të brendshëm dhe të jashtëm

Muret e brendshëm do të lyhen me hidromat, tavanet me hidromat, kurse pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me bojë akrilik me ngjyrë të ndryshme ose jo nga muret, bojë antialergjike, gjë e cila do të vendoset në bashkëpunim me stafin e shkollës.

2.3.4.7 Fasada

Fasada e shkollës, të jetë e tillë që të mirëmbahet lehtë, të evitohen sipërfaqet e mëdha të xhamit atje ku është e mundur, kurse ngjyrat e fasadës të jenë të bukura, në mënyrë që objekti të bëhet më atraktive për nxënësit. Fasadat duhet të jenë të veshura me kapotë termike, apo zgjidhje të tjera më të

avancuara për izolim termik dhe antizjarr. Konsulenti duhet të përcaktojë gjithashtu vendndodhjen e tabelës me emrin e shkollës.

2.3.4.8 Shtresat e pllakave

Pllakat ekzistuese të dyshemesë së vjetër së bashku me llaçin e vjetër nëse është e nevojshme do të zëvendësohen nga shtresa e re e dyshemesë, me pllaka, duke patur parasysh rinivelimin e saj me llaç – çimento si dhe me shtresat e nevojshme izoluese në rastin e ambienteve që nevojiten. Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izolohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specifikimet përkatëse.

2.3.4.9 Shkallët

Është e nevojshme përcaktimi i qartë i gjendjes së shkallëve, si nga ana funksionale në lidhje me kapacitetin ashtu edhe nga pikëpamja konstruktive. Edhe nëse shkallët nuk kanë nevojë për rikonstruksion, bazamakët dhe parapetet duhet të ribëhen.

Projekti duhet të përmbajë të gjitha detajet si dhe specifikimet teknike të domosdoshme për fazën e projekt zbatimit.

2.3.4.10 Dyer, dritare

Projektuesi duhet të përcaktojë që materialet që do të përdoren të jenë të cilësisë së lartë. Nëse janë propozuar dyer prej druri, ato duhet të jenë prej druri të fortë me mentesha të forta (minimumi tre për çdo derë) dhe sipas standardeve të MAS.

Dritaret dhe dyert që janë në kontakt me ambientin e jashtëm do të jenë prej duralumini, me dopio xham, me një xham termik në pjesën që ka kontakt me ambientin jashtë.

Vendosja e dyerve dhe plani i hapjes së tyre të realizohet i tillë që të plotësojë kushtet e daljes së shpejtë në raste emergjencash (me hapje nga korridori) dhe standardet e vendosura nga MAS.

Përsa i përket dritareve do të jenë duralumini të cilësisë së lartë me hapje me rrotullim dopio-xham dhe me sopralluce në ambiente që e kërkojnë atë. Gjithashtu për katet e para duhet të jetë të parashikuara të gjitha normat e sigurisë, pra edhe pajisja e tyre me elementet metalike mbrojtës përkatës.

2.3.4.11 Kalimet e emergjencës, shkallët, korridoret

Konsulenti duhet të parashikojë dhe kalimet e emergjencës (shkallët, korridoret). Numri dhe gjerësia e kalimeve të emergjencës duhet të sigurojnë largimin sa më të shpejtë dhe shfrytëzimi i tyre të nxjerrë në vend të sigurt jashtë ndërtesës me një rrugë të shkurtër, të shpejtë dhe pa rrezik.

Për përcaktimin e gjerësisë dhe gjatësisë së rrugëve të emergjencës, faktori kryesor është kohëzgjatja e largimit të personave nga objekti. Koha maksimale e largimit nga objekti në sekonda për çdo dhomë, mbas dhënies së sinjalit të alarmit duhet të jepet e llogaritur nga projektuesi.

Materiali për planet e evakuimit në rast emergjencash do të merren nga Bashkia Elbasan.

2.3.4.12 Ambientet sanitare

Në bashkëpunim me stafin mësimor, konsulenti duhet të parashikojë ambiente higjeno- sanitare të përshtatshme për nxënësit e grupmohës, 15 deri 18 vjeç.

Nyjet sanitare të jenë të veçanta dhe lavamanët të jenë të mjaftueshëm për numrin e nxënësve. Të sigurohet ujë i vazhdueshëm dhe i ngrohtë në lavamanë, për këtë arsye të shikohet mundësia e instalimit të boliereve, si dhe realizimi i rrjetit të nevojshëm hidraulik në rast se vlerësohet e nevojshme.

Banja dhe parabanja të jenë të ajrosura, të ndriçuara dhe të ventiluar. Në rast se s'ka ajrim direkt duhet të pajisen me impiant ajrimi dhe ventilimi. Kollonat e shkarkimit të jenë të shkëputura nga kanalet e ventilimit, me ajrim të jashtëm dhe shkarkimet të jenë të kontrollueshme.

Banjat të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja dhe të përjashtohet hapja nga brenda, për raste emergjence.

Për katin përdhe duhet të ofrohen sipas standardeve kushte për akses në nyjet higjieno-sanitare për personat me aftësi të kufizuara (PAK).

2.3.4.13 Ambientet sportive

Për terrenet e jashtme sportive ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit, pasi në periudhat e reshjeve këto ambiente bëhen me baltë, sepse është tokë natyrore, pa kushtet e duhura për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik. Terrenet e jashtme sportive kanë nevojë për sistemim.

2.3.4.14 Sistemit e jashtme dhe ambientet e gjelbëruara

Sistemit të oborrit të shkollës duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë. Ai duhet të rezultojë me rrethim transparent (kangjella, etj) dhe të garantojë të gjitha normat e sigurisë dhe standardeve për ndërtime të këtij lloji. Ambientet e jashtme janë ambiente që kryesisht shërbejnë për qëndrim, çlodhje prandaj rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i një sipërfaqeje të gjelbër dhe me pemë. Projektuesi duhet të japë të detajuara shtresat përkatëse dhe teknologjinë e zbatimit të tyre, dhe të kombinojë ambientet e qëndrimit/rreshtimit me ambientet e gjelbëruara.

Konsulenti duhet t'i jap rëndësi dhe të parashikojë dhe ndriçimin e jashtëm të objektit, në përputhje me planin e zhvillimit të territorit të kësaj zone dhe në përputhje me kërkesat e veçanta për rrjetin e ndriçimit të dhënë në këtë detyrë projektimi.

Për të mbajtur pastërtinë e oborrit të shkollës, në projekt/preventiv të parashikohet vendosja e koshave për mbeturinat, sidomos në afërsi të stolave.

T'i kushtohet kujdes i veçantë, sistemit dhe disiplinimit të ujërave sipërfaqësore të cilat janë problematike për këtë objekt.

2.3.5 Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të merren parasysh sa më poshtë:

- Të merret në konsideratë perspektiva 10-vjeçare e rritjes së numrit të fëmijëve për kapacitetin maksimal të shkollës. Të merret në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonave ku ndodhen objektet, por gjithashtu konsulenti duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona, nëse ka.
- Drejtimi i zhvillimit të territorit të zonës do të merret në Bashki.

Sistemi i largimit të ujërave të bardha dhe të zeza do të jetë mik.

Në përputhje me normat, konsulenti duhet të ketë parasysh numrin e fëmijëve, stafin mësimor dhe administrativ.

Konsulenti duhet të verifikojë gjendjen teknike të nyjeve higjieno-sanitare ekzistuese dhe duhet të përgatisë projektin e detajuar si për rikonstruksionin e atyre ekzistuese ashtu edhe të shtesës eventuale të kapacitetit (numrit) të tyre.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkëkohore dhe në përputhje me standardet në fuqi.

Rrjeti i amortizuar i ujësjellësit do të zëvendësohet. Gjithashtu në bashkëpunim me shoqërinë e Ujësjellës Kanalizime Elbasan do saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit ekzistues të zonës, si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës.

Materialet që do përdoren për rrjetin e brendshëm të ujësjellësit do jenë tuba polietileni me densitet të lartë për ujë të pijshëm me diametër dhe aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Për nyjen e marrjes nga rrjeti i zonës do të parashikohet puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Nëse është e domosdoshme, projektuesi duhet të parashikojë zëvendësimin dhe nxjerrjen jashtë pune të sistemit të vjetër të furnizimit me ujë.

Projektuesi të parashikojë në projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë nga pika e marrjes së dhënë nga Ujësjellës Kanalizime Elbasan deri tek matësi i ujit.

Të parashikohet realizimi i depozitave të ujit, të nevojshme në raste emergjence, si dhe lidhja e tyre në, me të paktën dy prej lavamanëve dhe nyjeve sanitareve si dhe depozitat e ujit për MNZ.

2.3.6 Rrjeti elektrik, telefonik dhe kompjuterik

Rikonstruksioni i objekteve duhet të përfshijë edhe instalimin e ri elektrik, telefonik dhe vlerësimin në rast se nevojitet për përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit të internetit në laboratorin e informatikës dhe zyrave të administratës.

Konsulenti duhet të parashikojë ndriçimin e ambienteve me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre. Projektuesi duhet të japë detajin e fiksimit të ndriçuesve si dhe dimensionet e elementeve në të cilat ato do të kapen.

Panelet e komandimit të vendosen të rinj sipas standardeve bashkëkohore.

Në këto kushte projektuesi duhet të parashikojë neqoftëse nevojitet dhe instalimin e rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionim normal të sistemit elektrik me të gjitha pajisjet e saj. Projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e matësit elektrik trefazor, dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kabllit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar.

Pozicionimi i ndriçuesve për secilin ambient duhet të përputhet me konceptin arkitekturor të përgjithshëm, në përputhje me funksionin e ambientit dhe standardet kundrejt tij.

Ndriçuesit e propozuar duhet të shmangin elementët e rrezikshmërisë, emetimin e lëndëve të rrezikshme për shëndetin, përdorimin materialeve që shkaktojnë mbetje të dëmshme për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve, duke ofruar dhe konsum energjie ekonomik me llampa LED.

Ndriçimi në ambiente duhet të jetë shlodhës dhe plotësojë normativat e detyrueshme nga tipologjia funksionale e tyre. Shpërndarja e ndriçuesve në ambient duhet të përshtatet me kërkesat funksionale të

tij, duke ruajtur sipas rastit një shpërndarje të njëtrajtshme të dritës. Kjo zgjidhje duhet gjithsesi të përmbushë kërkesat nominale të ambientit për ndriçim, sipas tipologjisë, pa cënuar konceptin e përgjithshëm të pasqyruar në projektin arkitekturor mbi estetikën, zgjidhjen e tavanëve, mureve dhe hapsirave të punës dhe ndriçimin e përgjithshëm të interierit. Tipologjia, estetika, këndi i hedhjes së dritës dhe gjeometria e secilit ndriçues duhet të përcaktohet në bashkëpunim me projektuesin arkitekt duke mbajtur në konsideratë lartësinë e ambientit dhe tavanëve të varur (në rast se janë propozuar). Drita ideale duhet të vijë në tavolinën e punës me kënd anësor dhe jo pingul. Shkëlqimi i sipërfaqeve duhet të kufizohet.

Pavarësisht referencave më sipër, nisur nga specifikat e veçanta të secilit ambient funksional, mbetet në gjykimin e projektuesit përdorimi i një standardi minimal ndriçimi, ose një tjetri, bazuar në kërkesat e saktësuara për secilin ambient, në përputhje me veprimtarinë dhe proceset e punës, për të cilët është projektuar.

Vendosja e prizave elektrike, Lan, sistemeve audio video etj. duhet të përputhet me hapësirat e punës të propozuara nga arkitekti në projektin e mobilimit.

Në tërësi në hartimin e projektit do të mbahen parasysh këto kërkesa për projektimin dhe zbatimin e rrjetit elektrik dhe elektronik:

- Të gjithë instalimet elektrike, kabllot dhe ndriçuesit, çelësat, prizat etj. duhet të jenë hermetikë.
- Ndriçimi elektrik duhet të zbatohet sipas normat e CE.
- Sistemi elektronik duhet të konceptohet me server (servera) qendror të veçantë.
- Në projektin elektrik duhet të parashikohet edhe instalimi i ndriçimit të emergjencës, në rastet e shkëputjeve të rrymës, apo emergjence të çfarëdo lloji.
- Në ndërtesë duhet të parashikohen sisteme elektrike dhe elektronike të nevojshme për mirëfunksionimin e ndërtesës. Krahas sa më sipër, të shqyrtohet **mundësia e integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë**.
- Projekti elektrik të jetë i shoqëruar me licencën e inxhinierit elektrik. Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe llambat me bateri të karikueshme, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.
- Projekti duhet të përmajë rrjetin e ndriçimit, ku përfshihet edhe ndriçimi i ambienteve të jashtëm dhe ndriçimi i emergjencës, rrjetin e prizave të furnizimit me energji, të prizave të UPS, rrjetin e furnizimit me energji elektrike nga OSHEE, sistemin e telefonisë, rrjetit LAN, sinjalizimit të zjarrit, sistemin video, acces-control, sistemin e vëzhgimit me kamera, sistemin e rrufepitjes etj., në harmoni me kërkesat e projektit arkitekturor.

2.3.7 Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë

Dhoma e transformatorit duhet të jetë e izoluar nga dhomat e tjera me mur zjarrdurues dhe nuk duhet të ketë lidhje me kalimet e emergjencës.

I gjithë sistemi elektrik duhet të jetë i tillë që të stakohet në një pikë të vetme në katin përdhe, e cila mund të arrihet lehtë dhe të ketë shenjat dalluese përkatëse. Skema elektrike e ndriçimit dhe e fuqisë duhet të jetë e afishuar në panelin e stakimit.

Nuk lejohet që tubacionet e sistemeve të tjera (ngrohjes, ujit të ngrohtë etj) të vendosen në të njëjtin kanal.

Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni. Ndriçimi i emergjencës dhe i sigurisë duhet të vendoset në ambientet e mëposhtme:

- *Korridore, të cilat shërbejnë edhe si rrugë largimi emergjence;*
- *Në shkallë deri në largimin nga objekti;*
- *Dhoma që shërbejnë si salla mbledhjesh;*
- *Në ambientet që nuk kanë dritare;*
- *Në të gjitha dhomat e furnizimit me energji (gas, elektricitet etj).*

2.3.8 Sistemi i mbrojtjes atmosferike

Shkollat duhet patjetër të kenë sistemin e mbrojtjes atmosferike pasi Shqipëria gjendet në një zonë me shkarkime atmosferike të shumta.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike duhet të bëhet duke u bazuar në kushtet teknike të përcaktuara dhe në specifikimet e materialeve të ndërtimit.

2.3.9 Sistemi ngrohës dhe i ventilimit

Konsulenti duhet të parashikojë ndërtimin e plotë të sistemit ngrohës (ngrohje qendrore) duke argumentuar nga ana tekniko – ekonomike zgjedhjen e mënyrës së ngrohjes, por njëkohësisht projekti të sigurojë ventilimin e ambienteve.

Projektuesi duhet të parashikojë instalimin e rrjetit elektrik me fuqi të tillë (tre fazor) që të sigurojë funksionim normal të sistemit të ngrohjes.

Konsulenti të shikojë mundësinë për ndërtimin e një ambienti teknik të veçantë ku të instalohet kaldaja, grupi i pompave, rezervuarët e ujit sanitar dhe ujit për MNZ-në.

Në projekt duhet të jepet qartë dhe e detajuar, vendndodhja e dhomës së kaldajës dhe karakteristikat e saj, vendodhja e rezervuarit të naftës/ambienti i depozitimit të peletit, të cilat duhet të jenë në pozicion të tillë që të furnizohen lehtë me lëndë djegëse, dimensionet dhe lloji i tubacioneve, kolektorëve, radiatorëve që do të përdoren, të gjitha llogaritjet e bëra si edhe detajet e nevojshme së bashku me specifikimet teknike përkatëse për fazën e projekt zbatimit.

Në dhomën e kaldajës të parashikohet një dritare e hapshme, ose grilë e cila do të shërbejë për ajrimin e dhomës nga gazrat e krijuara, si dhe të parashikohet ventilimi mekanik (aspirator) i tij dhe instalimi i një lavamani.

Në llogaritjet për kapacitetin e rezervuarit të naftës, konsulenti duhet të marrë në konsideratë se gjatë sezonit të dimrit furnizimi nga Bashkia kryhet *dy deri në tre herë* me lëndë djegëse. Në rastin e sistemit të ngrohjes me peletë, projektuesi duhet të parashikojë ambientin e depozitimit të lëndës djegëse të tillë që të sigurojë një nivel lagështie jo më shumë se 10 %.

2.3.10 Sistemi i mbrojtjes nga zjarrit (MNZ)

Konsulenti duhet të paraqesë dhe projektin e mbrojtjes nga zjarri, si dhe rregullat e sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standardeve evropiane.

Kërkohet të zgjidhet me mundësinë për vendosjen e shkallëve të emergjencës dhe kafaz metalik rrethues.

Sistemi i lajmërimit për zjarrin

Në objekt të shikohet mundësia e një kabinë telefonike që të mund të përdoret në çdo moment. Numrat e telefonit të zjarrfikësit duhet të jenë të afishuar dukshëm në këtë kabinë.

Ndërtesa duhet të ketë gjithashtu sistemin e brendshëm të alarmit, nëpërmjet të cilit në rast rreziku të bëhet largimi nga ndërtesa.

Sinjali i alarmit duhet të transmetohet në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jetë i qartë dhe i kuptueshëm nga të gjithë. Sistemi i alarmit duhet të futet në punë pavarësisht nga furnizimi me energji elektrike i objektit.

Sinjalizuesit e tymit

Këto do të veprojnë në mënyrë që të mbajnë ekuilibrin ndërmjet dhomës së hapur dhe të mbyllur, kështu kur tymi depërton në dhomën e hapur ai do të ketë kontakt me qarkun dhe do të aktivizojë sinjalin.

Të gjithë sinjalizuesit e tymit, të jenë instaluar të tilla që të mund të ndërrohen me zëvendësues.

Bombulat fikëse të zjarrit

Bombulat fikëse (me shkumë ose pluhur) duhet të vendosen në korridore dhe në ambientin teknik.

2.3.11 Raporti dhe auditimi i efikasitetit energjetic

Mbështetur në VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 (hyrja në fuqi 21.05.2015) "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e azhurnuar, pjesë e dokumentacionit për marrjen e Lejes së Ndërtimit duhet të jetë edhe projekti i efikasitetit energjetic, në rastet kur është e detyrueshme me ligj.

Pjesë e dokumentacionit të projektimit duhet të jetë edhe Raporti mbi efikasitetin e energjetic të ndërhyrjes së propozuar. Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për efikasitetin e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

Kur projektohet një ndërtesë e re ose kur një ndërtesë duhet t'i nënshtrohet një rinovimi të rëndësishëm, subjekti që ka apo do të ketë në pronësi apo përgjegjësi administrimi këtë ndërtesë, duhet të marrë në konsideratë zbatimin e kërkesave të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë së ndërtesave dhe të analizojë mundësinë e përdorimit të sistemeve me një performancë të lartë të energjisë, të parashikuara në Ligjin 116/2016 "PËR PERFORMANCËN E ENERGIJË SË NDËRTESAVE" neni 8 e vijues.

Hartimi i propozimeve të zgjidhjeve teknike në respektim të kriterëve të efikasitetit energjetic të ndërtesës së parashikura, duhet të kryhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të

përfshirë, më qëllim që në të gjithë projektet specifike të mbahen në konsideratë kriteret e efikasitetit energjetic, për arritjen e një performancë sa më të mirë energjeticë të të gjithë ndërtesës.

Hartimi i Raportit të efikasitetit energjetic duhet të kryhet në përputhje me metodologjinë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa, sipas nenit 5 të Ligjit 116/2016 më sipër cituar.

Gjatë procesit të projektimit duhet paraprakisht të kryhet vlerësimi i mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjie. Gjatë vlerësimit teknik të mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjie, duhet të merren në konsideratë çështjet mjedisore dhe ekonomike.

Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për efikasitetin e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

2.3.12 Kërkesat teknike kundrejt shërbimit të VNM

Në rast nevojë referuar legjislacionit përkatës në fuqi, nga vlerësimi sipas ndërhyrjeve që ofron projektuesi, Raporti i VNM/VNM do të mundësohet nga Bashkia Elbasan.

- Kërkesa të veçanta

Në realizimin e projektit të rikonstruksionit, si dhe atij të mirëfilltë arkitektonik duhen patur parasysh dhe të gjejnë zbatimin e duhur të gjitha rregullat dhe normat urbanistike dhe arkitektonike për personat me aftësi të kufizuar PAK.

Projektuesi duhet të parashikojë në projekt/preventiv edhe rampat për lëvizjet e fëmijëve më aftësi të kufizuar (PAK), sinjalistika për të verbërit, etj.

- Projektuesi gjithashtu duhet të sigurojë azhurnimin e rrjeteve inxhinierike të infrastrukturës për objektin nga institucionet kompetente.
- Dokumentacioni ligjor që shoqëron dosjen e paraqitur për leje ndërtimi sipas formularëve përkatës, (përveç konfirmimit të pronësisë së objektit, azhurnimit topografik, pagesat për certifikatën e performancës së energjisë në Agjencinë e Efikasitetit të Energjisë, Oponencën Teknikë në Institutin e Ndërtimit, kërkesat teknike kundrejt shërbimit të VNM, vlerësuar sipas ndërhyrjeve që ofron projekti) që do të sigurohen nga bashkia), do të përgatiten nga vetë projektuesi.

3. HARTIMI I PREVENTIVIT

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve në fuqi. Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do t'i bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas çmimeve të V.K.M nr. 616, datë 13.04.2023.

4. STANDARDET

4.1 Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuara, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

4.2 Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për planifikimin e territorit”.

5. REALIZIMI I PROJEKTIT

Projekti i paraqitur për Rikonstruksionin e Shkollës "Vasil Kamami" duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Terriori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim” për dokumentacionin përkatës:

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit të objektit “Rikonstruksion i Shkollës Vasil Kamami” me përmbajtjen si më poshtë:

- *Raporti Teknik;*
- *Projektin arkitektonik: Relacion arkitektonik i objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i mbulesës, etj;*
- *Projektin e zbatimit/konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.*
- *Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve;*
- *Projekt Zbatimin e instalimeve elektrike, të shoqëruara me licencën e projektuesit;*
- *Projekt Zbatimin e instalimit të sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit;*
- *Projektin e sistemit dhe të gjelbërimit të oborrit, projektin e ambienteve të lojrave;*
- *Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;*
- *Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;*
- *Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren;*

- *Relacionin gjeologjik për shtesat e reja të parashikuara;*
- *Raportin e Ndikimit në Mjedis (vlerësuar në rast nevoje me Bashkinë sipas kriterëve për leje ndërtimi);*
- *Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut;*
- *Analizat teknike të çmimeve të zërave të punime që nuk janë në manual;*
- *Planin e organizimit të punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve që do jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur në grafikun e punimeve;*
- *Licencë të firmës projektuese, licencë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtar.*
- *Raporin e auditimit të energjisë për objektin e projektit teknik;*
- *Deklaratat e përgjegjësisë profesionale për secilin ekspert kryesor (arkitekt, inxhinier konstruktor, inxhinier mekanik, auditues energjetik, inxhinier elektrik, etj) që nënshkruan projektin;*
- *Policat e sigurimit për secilin ekspert kryesor (arkitekt, inxhinier konstruktor, inxhinier mekanik, auditues energjetik, inxhinier elektrik, etj) që nënshkruan projektin.*

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet shkolla. Sistemin ekzistues të largimit të ujërave, Sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, Sistemin ndriçues rrugor, distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Elbasanit, seksioni i urbanistikës dhe nga kadastra e asetet.
- Konsulentit do t'i vihet në dispozicion edhe një Program Standard i ambienteve ku janë përcaktuar standardet minimale të organizimit të hapësirave të brendshme, lloji i ambienteve të detyrueshme, instruksione mbi funksionet që duhet të akomodohen, sipërfaqet funksionale të rrethimeve dhe sistemeve të jashtme, etj.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë:

- Plani i vendosjes së strukturës i cili do të hartohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Projekteve dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit) pranë Bashkisë së Elbasanit.
- Licencë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të Regjistrit Tregtar.
- Licenca të inxhinierëve projektues, licenca të ekspertit mjedisor + deklarata noteriale të inxhinierëve projektues.
- Projekti i plotë elektrik (planvendosjen e të gjitha pajisjeve elektrike, sistemi data - telefoni, projekti i MNZ, i mbrojtjes atmosferike dhe tokëzimit) të printuara në formatin A3, shkalla 1:1000 në 4 kopje origjinale;
- Kopja e licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektin (në 4 kopje);
- Planvendosja e objektit në shkallën 1 : 1000 format A3 (kopje origjinale);

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Elbasanit. Studio e licencuar (e pajisur me NIPT dhe QKB) për projektim duhet të ketë të punësuar të paktën 3 punonjës, ku një prej tyre të jetë arkitekt, dhe pjesa tjetër e specialistëve të nevojshëm për hartimin e projektit teknik mund të realizohet me ekspertë të jashtëm të dakordësuar mes tyre sipas legjislacionit përkatës.

Secili ekspert, pjesëtar i Grupit të Projektimit, duhet të ofrojë një shërbim profesional dhe të ketë kualifikimin e nevojshëm për kryerjen e këtij shërbimi. Për secilin ekspert do të paraqiten CV –të dhe licensat përkatëse.

Stafi që kërkohet duhet të mbulojë:

- *Arkitekt;*
- *Inxhinier ndërtimi (i specializuar në fushën e projektimit të strukturave).*
- *Inxhinier ndërtimi (i profilit hidroteknik);*
- *Inxhinier për sistemet e ngrohjes;*
- *Inxhinier elektrik/elektronik.;*
- *Auditues energjetik.*

Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

Për këtë fazë të punës, duhet të përgatitet dokumentacioni tekniko - ligjor përkatës, në përputhje me kërkesat ligjore, me qëllim plotësimin e dosjes për marrjen e lejes së ndërtimit, sipas tipologjive të lejeve. Përmbajtja e dosjes për leje ndërtimi përcaktohet nga legjislativi në fuqi. Këtu përfshihet përgatitja e dosjes për projektin teknik, përgatitja e dosjes për kryerjen e oponencës teknike, dokumentacioni për marrjen e pëlqimit mjedisor në rast nevojë, dokumentacioni për marrjen e certifikatës së auditimit energjetik.

6. KOHËZGJATJA E KRYERJES SË SHËRBIMIT

Periudha e fillimit

Data e parashikuar e fillimit për ofrimin e shërbimeve do të jetë data e përcaktuar në kontratën e shërbimit.

Periudha e përfundimit e parashikuar, ose kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shërbimit do të përcaktohet në ditë kalendarike në kontratën mes palëve. Kjo kohëzgjatje shërbimesh është parashikuar për shërbimin e kërkuar. Kjo kohëzgjatje është parashikuar për përgatitjen e projektit sipas fazave dhe dokumenteve të kërkuara në pikën 5.

Duhet të theksohet se kohëzgjatja e përgjithshme e hartimit të projektit ka të bëjë me dorëzimin e dokumentacionit pranë Porositësit. Grupi i Projektimit duhet të jetë i gatshëm të angazhohet për plotësimin, dorëzimin dhe mbrojtjen e projektit sipas kërkesave të institucioneve lejuese, me qëllim marrjen e lejeve të nevojshme për zbatimin e tij.

Grupi i projektimit duhet të konsiderojë se takimi fillestar do të organizohet me pjesëmarrjen e ekipit projektues, grupit të hartimit të detyrës së projektimit dhe përfaqësuesve të përfituesve.

Drejtuesi i ekipit të projektimit do të jetë përgjegjës për organizimin e takimeve dhe koordinimin e procesit të projektimit. Grupi i Projektimit duhet të paraqesë planin e punës për të siguruar përdorimin efikas të burimeve dhe për të përshatur kërkesat aktuale të punës me kërkesat paraprake.

7. RAPORTIMI

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe ku të paktën dy nga kopjet të jenë të printuara me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dwg” (AutoCad 2016-2022). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 2 CD).

- Të gjithë raportet do të dorëzohen në formë fizike dhe në formë elektronike pranë Porositësit, në format të lexueshme. Shkrimet dhe detajet të dallohen qartë.
- Vizatimet dhe raportet e projekt – preventivit të zbatimit duhet të jenë në 4 (katër) kopje origjinale të printuara dhe 2 (dy) CD me të gjitha materialet në formatet përkatëse (autocad, word, excel, etj.).
- Në CD duhet të bashkëlidhen edhe versionet "pdf" të të gjithë materialeve bashkë me nënshkrimin elektronik për çdo profil eksperti sipas dokumentacionit të nevojshëm për aplikim për leje ndërtimi nga Bashkia Elbasan në sistemin "e-leje".
- Të gjithë dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga të gjithë anëtarët e ekipit të projektimit.

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- *Raportin teknik të projektimit arkitektonik;*
- *Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat që përfshin ndërhyrja (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.) si dhe masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e investitorit.*
- *Relacionin sizmologjik të truallit (kur nuk ka studim, një përshkrim i përgjithshëm);*
- *Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.*

Relacioni gjeologjik dhe vetitë fiziko-mekanike të dherave ku duhet të paraqiten.

- *Cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit ekzistues.*
- *Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.*

8. PARAQITJA E VIZATIMEVE

Vizatimet në fazë projekt zbatimi duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

1. *Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme*
2. *Planvendosja e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500*
3. *Planimetritë e kateve ekzistuese Shk. 1:100, 1:50*
4. *Planimetritë e objektit pas ndryshimeve Shk. 1:100; 1:50*
5. *Fasadat ekzistuese Shk.1:100*
6. *Fasadat e reja në 2D dhe 3D Shk.1:100*
7. *Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100*
8. *Planimetria e themeleve Shk.1:100*
9. *Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10*
10. *Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50*
11. *Planimetritë e mobilimit të shkollës Shk.1:100*
12. *Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100*
13. *Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20*
14. *Planimetria e furnizimit me ujë në Shk. 1: 200, 1:100*
15. *Skemat aksonometrike të furnizimit me ujë, detaje të pajisjeve hidrosanitare Shk.1:100*

16. *Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10*
17. *Planimetria, aksonometria dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100*
18. *Planimetria dhe detaje të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100*
19. *Planimetria e dhomës së kaldajës, konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50*
20. *Planimetri dhe detaje për ndriçimin, fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50*
21. *Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objektin, Shk. 1:100*
22. *Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50*
23. *Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50*
24. *Planimetria e ambienteve sportive dhe ambienteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50*
25. *Planimetria e murit rrethues, tipin dhe detajin e fiksimit të stolave Shk.1:100; 1:50.*
26. *Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50.*

9. PREVENTIVI

Grupi i Projektimit duhet të paraqesë detyrimisht preventivin përfundimtar të punimeve. Çdo zë i këtij preventivi duhet të mbështetet në Klasifikimet Ligjore të Kostove dhe Analizat Teknike të Çmimeve nga Manualet Teknike përkatëse, në përputhje me VKM në fuqi (V.K.M nr. 616, datë 13.04.2023). Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale, të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut duke marrë tre oferta nga operatorë ekonomike, që operojnë në vendin tonë (oferta që do të bëhen pjesë e dokumentit të dorëzuar). Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndarë sipas kategorive dhe zërave të punës.

Harmonizimi dhe koordinimi i kategorive të punës së projektit të bëra nga specialistët e përfshirë në planifikimin e projektit, përfshirë fondin rezervë dhe T.V.Sh. 20 %.

10. INVESTIMI THEMELOR

Projekti teknik do të aprovohet nga Europartners Development si aplikues i grantit të UNICEF Albania për programin "Infrastruktura shkollore" dhe nga Bashkia e Elbasanit.

Duke marrë në konsideratë investime të ngjashme nga bashkia Elbasan, vlera e përlloritur paraprake për këtë investim për zbatim është rreth **157,072,200** (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milion e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë (me TVSH).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

GLEDIAN LLATJA



DETYRË PROJEKTIMI

“Rikonstruksioni i Shkollës "Anastas Çakalli"”

Kuqan

Elbasan, Gusht 2024

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	2
1.1	Institucioni përfitues	2
1.2	Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje	2
1.3	Baza ligjore	2
1.4	Qëllimi i projektit të investimit	3
1.5	Objektivat e projektit të investimit	3
2.	PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT	3
2.1	Qëllimi	3
2.2	Objektivat.....	4
2.3	Përshkrim i përgjithshëm	4
2.3.1	Pozicionimi i parcelës që zhvillohet	4
2.3.2	Gjendja faktike	5
2.3.3	Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor	10
2.3.4	Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv	13
2.3.5	Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve	15
2.3.6	Rrjeti elektrik, telefonik dhe kompjuterik.....	16
2.3.7	Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë	17
2.3.8	Sistemi i mbrojtjes atmosferike	18
2.3.9	Sistemi ngrohës dhe i ventilimit.....	18
2.3.10	Sistemi i mbrojtjes nga zjarrit (MNZ)	19
2.3.11	Raporti dhe auditimi i efencës energjitike	19
2.3.12	Kërkesat teknike kundrejt shërbimit të VNM	20
3.	HARTIMI I PREVENTIVIT	20
4.	STANDARDET.....	21
5.	REALIZIMI I PROJEKTIT	21
	<i>Rekomandime për projektuesin</i>	<i>22</i>
	<i>Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar</i>	<i>23</i>
6.	KOHËZGJATJA E KRYERJES SË SHËRBIMIT	23
7.	RAPORTIMI.....	24
8.	PARAQITJA E VIZATIMEVE.....	24
9.	PREVENTIVI	25
10.	INVESTIMI THEMELOR	25

1. HYRJE

1.1 Institucioni përfitues

Institucioni përfitues i shërbimit në fushën e projektimit është Bashkia Elbasan. Përfituesi i këtij shërbimi është Institucion Publik.

Misioni i këtij institucioni është:

- Të sigurojë një shërbim arsimor sa më të mirë, të drejtë, transparent dhe gjithëpërfshirës për çdo nxënës, të shkollës së mesme të përgjithshme "Anastas Çakalli".

Vizioni "Elbasani, qyteti i fëmijëve".

Bashkia Elbasan zhvillon aktivitetin bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë në tërësi dhe legjislacionin e posaçëm për institucionet e arsimit parauniversitar në veçanti.

Përfituesit parësorë janë komuniteti i nxënësve që ndjekin arsimin në këtë shkollë, si dhe stafi pedagogjik i nivelit arsimor të kësaj shkolle.

Përfituesit e tërthortë janë prindërit e nxënësve që ndjekin arsimin në këtë shkollë si dhe komuniteti i banorëve të zonës përreth, si rritje e cilësisë së infrastrukturës së zonës urbane, por dhe mundësi për zgjedhje si shkollë me standarde për brezat e rinj pasardhës.

Nga realizimi i tij do të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë 82 nxënës, dhe 25 mësues, si dhe në mënyrë të tërthortë 164 prindër e komuniteti përreth.

1.2 Arsytimi i nevojës për ndërhyrje

Sipas vlerësimit teknik, shkolla ka nevojë për Rikonstruksion Tipi A. Punimet kryesore të rikonstruksionit të ndërtesës kanë të bëjnë me: rinovim total të pllakave të dyshemeve pasi janë vjetra që nga viti i ndërtimit; rinovim të suvatimeve të brendshme dhe jashtme të amortizuara nga lagështia; lysterje totale brenda dhe jashtë me bojë hidroplastike, sistem ngrohje, rinovim total të dritareve, dyerve të brendshme dhe derës së jashtme të shkollës; rinovim të sistemit elektrik të shkollës, përforcim të fuqisë së rrjetit, rinovim të prizave dhe çelësave; rinovimin e shtresave të hidroizolimeve të tarracës; riparim të ulluqeve; rinovim të dyshemesë të palestrës së brendshme si dhe disa riparime të suvave dhe lysterje të mureve; rinovim i terrenit sportiv jashtë sipas standardeve.

1.3 Baza ligjore

Bazuar në statusin ligjor të institucionit, ky shërbim në fushën e projektimit duhet të përmbushë kërkesat dhe të marrë në konsideratë referencat si vijon:

1. Ligj nr. 107, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
2. Ligj nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë";
3. Ligj nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
4. Ligj nr. 116/2016, "Për performancën e energjisë në ndërtesa";
5. VKM nr. 408, "Rregulloren e Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar;
6. VKM nr.1503, datë 19.11.2008 "Për miratimin e Rregullores "Për shfrytëzimin e hapsirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar";
7. VKM nr. 319, datë 12.04.2017, "Standardet për projektimit e shkollave";

8. VKM nr. 98, datë 06.02.2013, "Për miratimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare";

9. VKM nr. 68, datë 15.02.2001, "Për miratimin e standardeve dhe kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit";

10. "Rregullore për formatin e auditimit energjitik dhe pagesën e audituesit energjitik", miratuar me Urdhër nr. 5, datë 12.01.2021 të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë;

11. Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore, normat dhe standardet, miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

12. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Elbasan, miratuar me Vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016, i rishikuar;

13. Manualët, standardet dhe kushtet teknike shtetërore dhe evropiane normat ISO të projektimit të objekteve arsimore;

1.4 Qëllimi i projektit të investimit

Qëllimi i rikonstruksionit është "Të përmirësohet infrastruktura arsimore në Elbasan nëpërmjet ndërhyrjes infrastrukturore, si bazë për aplikimin e kushteve ndërtimore që sigurojnë standarde kombëtare për nxënësit dhe mësuesit, familjen dhe komunitetin, respektimin e të drejtave dhe përgatitjen e duhur të brezave të rinj të arsimuar".

1.5 Objektivat e projektit të investimit

Objektivi kryesor i këtij projekti është të sigurojë ambiente të projektuara dhe të përshtatura në përputhje me kërkesat dhe nevojat e veprimtarisë së arsimit të mesëm të përgjithshëm, në respektim të standardeve bashkëkohore infrastrukturore dhe çdo akti juridik, normativ, apo standard në fushën e projektimit të ndërtesave arsimore në Republikën e Shqipërisë.

Objektivat specifikë të këtij projekti investimi përmbledhen në vazhdim:

- Përshtatshmëria funksionale e mjediseve dhe zonimi hapësinor i tyre, në përputhje me kërkesat dhe standardet infrastrukturore për objektet arsimore parauniversitare dhe veprimtarinë institucionale të shkollës së mesme së përgjithshme.
- Plotësimi i mjediseve me sisteme, pajisje, rrjete dhe materiale ndërtimore bashkëkohore.
- Përmbyllja e kriterëve infrastrukturore për efikasitetin energjitik, komoditetin termoakustik, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat higjieno - sanitare dhe përshtatjen e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara.
- Sistemimi i mjediseve të jashtme në përputhje me kërkesat për mjedise rekreative, kërkesat drenazhimin e ujërave të shiut, ato për mbrojtjen e mjedisit dhe kriteret për orientimin e fluksit të nxënësve dhe mësuesve të shkollës.

2. PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT

2.1 Qëllimi

Detyra e Projektimit ka për qëllim parashtrimin e të dhënave thelbësore, njohëse, kërkesave dhe nevojave specifike të institucionit përfitues, në cilësinë e Porositësit, kundrejt shërbimit të kërkuar, si dhe orientimet mbi problematikën aktuale të shtruar për zgjidhje, mbi bazën e të cilave, grupi i projektimit, do të hartojë projektin për "Rikonstruksionin e shkollës së mesme të përgjithshme "Anastas Çakalli"".

2.2 Objektivat

Detyra e projektimit ka këto objektiva:

1. Të prezantojë grupin e projektimit me vendndodhjen, infrastrukturën dhe problematikën e gjendjes faktike të objektit që i nënshtrohet ndërhyrjes.
2. Të përshkruajë kërkesat sasiore dhe cilësore kundrejt shërbimit të porositur.
3. Të evidentojë kërkesat profesionale kundrejt grupit të projektimit.
4. Të shtjellojë formën, mënyrën dhe afatet e raportimit të materialeve pranë Porositësit.

2.3 Përshkrim i përgjithshëm

2.3.1 Pozicionimi i parcelës që zhvillohet

Parcela, në të cilën ndodhet objekti i cili i nënshtrohet ndërhyrjes, së parashikuar nëpërmjet kësaj detyre projektimi, ndodhet në Njësinë Administrative Kuqan, përgjatë rrugës "Boja", në parcelën kadastrale me nr. pasurie 84/1 dhe 84/2, në zonën kadastrale 2328. Topografia e zonës është e rrafshët.



Figura 1. Foto e fasadës kryesore të shkollës

Detyrë Projektimi - Rikonstruksioni i Shkollës "Anastas Çakalli"



Figura 2. Pozicioni i objektit në hartë kadastrale - plan rilevimi

2.3.2 Gjendja faktike

Analiza e gjendjes faktike të parcelës dhe objektit. Analiza e problematikës që sjell nevojën e investimit dhe kërkesave të shtjelluara në vijim.

Shkolla është e ndërtuar në vitin 1970, por nuk cilësohet si objekt me tipare historike. Sipërfaqja e territorit është 4410 m². Në të ndodhet godina 3 katëshe, me një sipërfaqe mbi tokë 1554 m², ku gjurma e objektit është 518 m² dhe lartësi ndërtese 11 m. Shkolla mbulohet me tarracë të rrafshët. Godina cilësohet me një kapacitet mbajtës 650 nxënës. Me një numër total prej 24 klasa. Shkolla është qendër komunitare me Klubin e anglishte, punimet artizanale, klubin e mjedisit dhe aktivitetet sportive.

Ndërtesa e shkollës cilësohet e sigurt për jetën. Ajo ka strukturë me muraturë mbajtëse me elementë (kolona, mure, trarë, soleta, themele) në gjendje të mirë dhe funksionale.



Figura 3. Foto e portës së shkollës



Figura 4. Foto të rrethimit së shkollës



Figura 5-6. Foto e terrreneve sportive të shkollës



Figura 6-7. Foto të terrenit të jashtëm të shkollës

Shkolla ndodhet në qendër të fshatit Kuqan, dhe aksesohet nga një rrugë e dedikuar shkollës, e aneksuar nga rruga Cërrik-Elbasan. Kjo rrugë është e pashtruar dhe pa trotuare. Orientimi është Perëndim-Lindje. Drita natyrale për klasat është e mirë dhe hijëzimi bëhet nëpërmjet perdeve me vetëfinancim. Sugjerohen të vendosen grila të brendshme. Rrethimi i shkollës nuk është uniform përreth gjithë sheshit, por një pjesë është me mur dhe kangjella metalike, dhe një pjesë tjetër është mur tulle. Rrethimi ka nevojë për rinovim.

Aksesi në shkollë bëhet nëpërmjet një porte metalike, buzë rrugës dedikuar shkollës. Shkolla ndodhet në një zonë të qetë dhe pa probleme.

Trualli i shkollës është mëse i mjaftueshëm për të përmbushur të gjitha nevojat e studentëve për mësimdhënie dhe aktivitete të tjera. Sipërfaqet e jashtme janë të mjaftueshme për të pasur terrrene sportive dhe elemente të tjera për mësimdhënien, të cilat aktualisht mungojnë.

Sipërfaqja mesatare e një klase është $5m \times 7,5m = 37,5m^2$, pra klasa për një numër nxënësish: 25. Sipërfaqja është brenda standardeve të VKM për sipërfaqet e klasave të shkollave rurale.

Ndriçimi mungon qoftë në oborr, qoftë në rrugë.

Shkolla ka sallë mësuesi, drejtori, nëndrejtori, zyrë për punonjës social. Ka gjithashtu laborator TIK (me 9 PC funksional). Mungon hapësira për laboratorë biologjie, fizike, kimie. Ka një sallë e dedikuar për aktivitete shumëpërdorimshe, si qeveria e nxënësve dhe klasa e qendrës komunitare.

Godina është e amortizuar prej lagështisë. Në korridore, klasa, tualete ndihen shumë aroma e mykut dhe lagështisë. Kërkohet hidroizolimi në tarracë, pasi ka shumë probleme.

Zona sportive jashtë ka 3 fusha sportive (1 futboll, 1 volejboll, 1 basketboll). Terrenet sportive janë totalisht jashtë standardeve të projektimit dhe kanë nevojë për rinovime.

Në shkollë mungon palestra, por një klasë është kthyer në kënd sportiv të brendshëm, por jashtë standardeve. Mungon baza materiale dhe pajisjet e duhura për edukimin fizik.

Detyrë Projektimi - Rikonstruksioni i Shkollës "Anastas Çakalli"



Figura 8-10. Foto të terrenit të gjelbër të shkollës

Bazuar në VKM nr. 319, oborri, gjelbërimi dhe hapësirat e qarkullimit duhet të përbëjnë 50-60% të territorit të shkollës. Shkolla e përmbush këtë kusht.

Shtrimi i oborrit, është bërë nga organizata "World Vision".



Figura 11-13. Foto të dritareve dhe dyerve të shkollës



Figura 14-16. Foto të korridorit hollit dhe shkallëve të shkollës



Figura 17-18. Foto të klasave të shkollës



Figura 19. Foto të laboratorit TIK



Figura 20. Foto të bibliotekës

Godina nuk ka nevojë për izolim akustik, pasi muret janë tulle, 45 cm dhe nuk e përcjellin tingullin. Dritaret janë dritare me kornizë duralumini me xham tek, e për rrjedhojë janë izoluese të këqija, por zona ku ndodhet shkolla është shumë e qetë dhe nuk ka ndotje akustike. Dyert e brendshme janë tamburat me veshje me MDF.

Ngrohja bëhet me soba druri. Në periudhën nëntor-mars shkolla konsumon 60m^3 dru. Në 2019, një klasë ka marrë zjarr nga rënia e tubit të sobës së drurit.

Shkolla ka një fikëse zjarri, dhuratë nga fondacioni "Save the Children".

Ka kosha prezent nëpër klasa, korridor dhe oborr. Mbetjet grumbullohen me thasë dhe derdhen në koshat e fshatit.

Lagështia është një problem shumë i madh, evident në muret e shkollës. Aroma e mykut ndihet në klasa kryesisht gjatë dimrit dhe sidomos në klasat në katin përdhe dhe në tualete.



Figura 21-25. Foto të tualeteve të shkollës

Pajisjet sanitare janë funksionale, por të amortizuara dhe të pamjaftueshme. Shkarkuesit e tualeteve janë të konsumuar, ose inekzistent. Ventilimi në tualete është natyral. Shkarkuesit e tualeteve janë të konsumuara. Rubinetet e lavamanëve kanë nevojë për rinovim.

Shkolla ka furnizim me ujë brenda ambienteve nga rrjeti i fshatit Kuqan, të rrjedhshëm 24 orë, por nuk është ujë i pijshëm.

Sistemi i KUZ nuk funksionon, po ka një gropë septike për dy shkolla, e cila bllokohet 2-3 herë në vit dhe lëshon aroma të këqija. Gropa kontrollohet dhe menaxhohet nga bashkia për çdo problem që ka.



Figura 26-28. Foto të rrjetit elektrik



Figura 29-31. Foto të suvatimeve të brendshme dhe të jashtme

Kërkesat teknike planimetriko – kompozicionale dhe infrastrukturore

Hartimi i projekteve specifike, të shtjelluar në vijim, duhet të mbështetet në studimet e thelluara të gjendjes faktike. Çdo dokument teknik që disponohet nga institucioni në shërbim të procesit të projektimit do t'i vendoset në dispozicion grupit të projektimit. Grupi i projektimit duhet të hartojë projektin mbështetur në konstruksionin e ndërtesës ekzistuese, pa anashkaluar kriteret për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e efikasitetit energjetic.

2.3.3 Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor

Me qëllim rritjen e efikasitetit energjetic të godinës projekti duhet të parashikojë veshjen termoizoluese të të gjithë fasadës veshëse të jashtme të godinës. Projekti arkitekturor duhet të mbajë në konsideratë përshtatjen e objektit për personat me aftësi të kufizuara të paktën për katin përdhe, referuar kategorizimeve të kufizimeve të ndryshme. Materialet e propozuara për të gjithë elementët ndarës dhe veshës, termoizolues, hidroizolues etj., duhet të jenë bashkëkohorë, të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe të shmangin elementët e rrezikshmërisë. Rëndësi duhet t'i kushtohet akustikës së ambienteve, izolimit nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës.

Gjatë të gjithë procesit të projektimit është e rëndësishme që të bashkëpunohet ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, pasi projekti arkitekturor duhet të reflektojë kërkesat e projektit strukturor, kërkesat e projekteve të sistemeve teknike, kërkesat e aspekteve arkitekturore të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat për efikasitetin energjetic, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe çdo kërkesë tjetër, të gjykuar si të nevojshme nga specialistët e përfshirë.

Stili arkitekturor

Stili arkitekturor duhet të respektojë funksionin e objektit si institucion publik, duke pasqyruar tendencat, frymën, teknikat dhe teknologjitë bashkëkohore. Stili i konceptimit të interiereve duhet të përputhet me funksionin e objektit. Ngjyra, estetika, stili dhe materialet e përdorur duhet të ndjekin të njëjtën linjë konceptuale, duke reflektuar edhe tendencat e kohës.

Rikonstruksion i plotë i objektit në përputhje me Standardin e Projektimit të Shkollave dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 12.04.2017, "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave", si dhe duke respektuar legjislacionin në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, si dhe rregulloret e zbatim të tij, në fuqi, distancat nga objekti ekzistues, distancat nga kufiri i pronës, ose distancat ekzistuese përse kohë nuk ndryshon volumi i ndërtesës, si dhe distancat nga aksi i rrugës në përfundim duke krijuar kështu hapësirat e nevojshme për lëvizjen e këmbësorëve, makinave, etj.

Godina do të jetë ekzistuese 3 kate, duke përmirësuar kushtet sipas standardeve për ambientet e mësimdhënies, administratës, higjienës-sanitare, rekreacionit dhe logjistikës.

- Do të bëhen shtresat dhe hidroizolimi i plotë i tarracës;
- Do të riparohet dhe konstruktohet rrethimi i shkollës ku ka dëmtime;
- Do të vendosen të reja ulluket vertikale dhe sistemimi i ujrave të shiut, duke u maskuar në fasadë;
- Do të prishen të gjitha suvatimet brenda, përfshirë palestrën dhe do të ribëhen të reja, me suva 0.1;
- Do të prishen të gjitha shtresat e pllakave brenda dhe do të bëhet shtrimi i tyre me pllaka gres porcelanate, me cilësi të parë, të parrëshqitshme;
- Shkallët do të rehabilitohen me veshje mermeri dhe rikonceptim të parapetit, duke përmirësuar dhe harmonizuar pjesën funksionale, pa rrezikshmëri në lëvizje apo rrëshqitje, si dhe me sinjalistikë identifikuese lehtësisht e dallueshme nga ana vizuale;


- Suvatimi i jashtëm do të bëhet me sistem kapotë dhe me grafiato 01, lyer me bojë hidroplastike, ose zgjedhje të tjera arkitektonike me fasadë të ventiluar apo më inovative, në harmoni me trajtimin estetik të interierit dhe eksterierit sipas standardeve për eficientë e energjisë.
- Dritaret do të kenë davancal mermeri me frezim për puthitjen e plotë të vetratave në konture për hidroizolim dhe plotë me ambientin e jashtëm;
- Dritaret dhe dyert që janë në kontakt me ambientin e jashtëm do të jenë prej duralumini, dopio xham. Xhami që është në kontakt me ambientin e jashtëm duhet të jetë termik dhe me transparencë;
- Fasada e shkollës, të jetë e tillë që të mirëmbahet lehtë, të evitohen sipërfaqet e mëdha të xhamit atje ku është e mundur, kurse ngjyrat e fasadës të jenë të bukura, në mënyrë që objekti të bëhet më atraktive për nxënësit. Fasadat duhet të jenë të veshura me kapotë termike, apo zgjidhje të tjera më të avancuara për izolim termik dhe antizjarr. Konsulenti duhet të përcaktojë gjithashtu vendndodhjen e tabelës me emrin e shkollës.
- Dyert e jashtëm që janë në katin përdhe do të jenë dyert të izoluara dhe rezistente ndaj goditjeve apo dëmtimeve në rast ushtrimi force;
- Dritaret e katit përdhe do të jenë me elementë mbrojtës metalike (psh. kangjella);
- Muret e brendshëm do të lyhen me hidromat, tavanet me hidromat, kurse pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me bojë akrilik me ngjyrë të ndryshme, ose jo nga muret, me bojë antialergjike, gjë e cila do të vendoset nga projektuesi;
- Instalimet elektrike do të bëhen të reja;
- Në të gjitha banjot do të shtohen kasetat e shkarkimit dhe përbën avantazh zgjidhja arkitektonike për kursimin e konsumit të ujit në mishelatorë dhe shkarkues wc;
- Kushtet higjieno-sanitare për tualetet e vajzave duhet të ofrojnë parametrat për kujdes personal gjatë periudhës së ciklit menstrual (ujë të ngrohtë, shataff, etj);
- E gjithë infrastruktura e internetit, energjisë elektrike, telefonisë, apo shërbime të tjera të nevojshme si rrjeti i kamerave, duhet të jetë i fshehur në mur dhe tavane të varur me kartonxhez, ku të mos shfaqet rrezikshmëri dhe mundësi dëmtimi gjatë përdorimit të ambienteve;
- Është parashikuar dhe sistemi qendror ngrohjes për të gjithë shkollën e palestrën me ambientet ndihmëse;
- Sipas orientimit natyral të ndërtesës të zgjidhet hijëzimi sipas nevojës, apo shtimi i ndriçimit artificial në interier për të plotësuar kapacitetin homogjen të nevojshëm për mësimdhënie;
- Të zgjidhet vendosja e shkallëve të emergjencës dhe kafazi metalik rrethues me një zgjidhje estetike harmonizuese me fasadën;
- Nevojitet sistemimi i gropave septike;
- Ndërtimi i një rampe për PAK në shkallët e hyrjes kryesore;
- Krijimi i laboratorëve dhe hapësirave që mungojnë;
- Kërkohej instalimi i sistemit rrufepritës dhe tokëzim;
- Përbën avantazh propozimi i një sistemi teknologjik dhe promjedisor për fasadën dhe sistemimin e jashtëm të terrenit të shkollës (gjelbërim, hijëzim, instalacione harmonike, ritmika, etj).

Katet përdhe, i parë dhe i dytë


Kati përdhe i cili ka një sipërfaqe 518 m². Shkallët janë të gjera e plotësojnë parametrat për objekte arsimore të këtij karakteri.

Gjithashtu, në këtë kat duhet organizuar aksesin për hyrjen dhe klasa të dedikuara për nxënësit, apo persona me aftësi të kufizuara PAK, një higjieno-sanitare edhe për persona me aftësi të kufizuara PAK, klasat, laboratorë, dhomat e zhveshjes, nyjet sanitare për meshkuj-femra, palestra, si dhe ambiente të tjera të nevojshme.

Kati i 3-te



Kati i 2-te



Kati i 1-re




Figura 32. Planimetritë për katin përdhe, të parë dhe të dytë

2.3.4 Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv

Hartimi i projektit konstruktiv duhet të mbajë në konsideratë propozimin e zgjidhjeve më të përshtatshme, referuar konceptit të përgjithshëm arkitekturor dhe funksionit të ambientit.

Materialet, teknikat dhe teknologjitë e propozuara duhet të respektojnë kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në mungesë të tyre projektuesi duhet t'u referohet Eurokodeve aktuale në përdorim.

Projekti konstruktiv duhet të respektojë kërkesat e jetëgjatësisë së projektimit, ngarkesave dhe rregullave të projektimit për sa i përket durabilitetit (Klasa e durabilitetit), në funksion të kushteve të ekspozimit të tij, bazuar në Eurokode.

2.3.4.1 Themelet

Kusht themelor dhe detyrë parësore teknike është verifikimi i themeleve të godinës ekzistuese si dhe përlllogaritja paraprake e aftësisë mbajtëse të tyre. Këtu përfshihet lloji i materialit me të cilin janë realizuar, përmasat, modalitetet e realizimit të tyre.

Në varësi të gjithë këtyre parametrave, të vetive fiziko-mekanike si dhe të thellësisë së tyre, konsulenti duhet të përcaktojë të gjitha mënyrat dhe mundësitë e ndërhyrjes në të në rast se vlerësohet e nevojshme.

2.3.4.2 Tarraca

Projektuesi duhet të japë të gjitha detajet për shtresat e hidroizolimit dhe vendosjen e kasetës së shkarkimit dhe ullukët vertikalë, si dhe detaje të tjera të domosdoshme për zbatimin e punimeve duke qenë se një pjesë e ujërave të shiut janë të pasistemuar dhe grumbullohen në ambientet e shkollës. Gjithashtu duhet të tregojë, numrin e ulluqeve dhe diametrat e tyre sipas normave në fuqi. Për sasitë e reshjeve do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik.

2.3.4.3 Soletat

Është detyrë e konsulentit, kontrolli dhe verifikimi teknik i soletave ekzistuese të objektit, në mënyrë që të parashikohet rikonstruksioni i tyre sidomos në rastet kur ka probleme, të lidhura me degradimin e tyre dhe me uljen e aftësive mbajtëse.

Ky lloj kontrolli është akoma më i domosdoshëm në rastin e tavanit të varur në katin e parë i cili është pjesërisht i shkatërruar dhe në disa klasa për arsye sigurie nuk zhvillohet mësim.

2.3.4.4 Muret

Konsulenti do të japë të gjitha detajet e përforcimit të muraturës mbajtëse në rastin kur ajo paraqitet me probleme.

2.3.4.5 Suvatimet

Objekti i rikonstruktuar duhet të suvatohet nga brenda dhe jashtë. Në pjesët e dëmtuara, suvatimet e mureve dhe tavaneve do të kryhen në të gjithë sipërfaqen përkatëse duke ruajtur shtresën e parë ekzistuese ku të mundet në mure, kurse tavanet të pastrohen dhe të risuvatohen. Të gjitha shtresat e tjera në rast se janë të dëmtuara do të hiqen pa dëmtuar muret.

Përsa i përket suvatimeve të jashtme do të jenë në varësi të llojit të ndërhyrjes që parashikon projekti, nëse do të restaurohet sipërfaqja ekzistuese, ose do të rishikohet e gjitha sipas konceptit të ri që kërkon fasada duke marrë në konsideratë dhe kushtet për efikasitetin e energjisë në ndërtesa.

2.3.4.6 Lyerja e mureve të brendshëm dhe të jashtëm

Muret e brendshëm do të lyhen me hidromat, tavanet me hidromat, kurse pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me bojë akrilik me ngjyrë të ndryshme ose jo nga muret, bojë antialergjike, gjë e cila do të vendoset në bashkëpunim me stafin e shkollës.

2.3.4.7 Fasada

Fasada e shkollës, të jetë e tillë që të mirëmbahet lehtë, të evitohen sipërfaqet e mëdha të xhamit atje ku është e mundur, kurse ngjyrat e fasadës të jenë të bukura, në mënyrë që objekti të bëhet më atraktive për nxënësit. Fasadat duhet të jenë të veshura me kapotë termike, apo zgjidhje të tjera më të avancuara për izolim termik dhe antizjarr. Konsulenti duhet të përcaktojë gjithashtu vendndodhjen e tabelës me emrin e shkollës.

2.3.4.8 Shtresat e pllakave

Pllakat ekzistuese të dyshemesë së vjetër së bashku me llaçin e vjetër nëse është e nevojshme do të zëvendësohen nga shtresa e re e dyshemesë, me pllaka, duke patur parasysh rinivelimin e saj me llaç – çimento si dhe me shtresat e nevojshme izoluese në rastin e ambienteve që nevojiten. Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izolohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specifikimet përkatëse.

2.3.4.9 Shkallët

Është e nevojshme përcaktimi i qartë i gjendjes së shkallëve, si nga ana funksionale në lidhje me kapacitetin ashtu edhe nga pikëpamja konstruktive. Edhe nëse shkallët nuk kanë nevojë për rikonstruksion, bazamakët dhe parapetet duhet të ribëhen.

Projekti duhet të përmbajë të gjitha detajet si dhe specifikimet teknike të domosdoshme për fazën e projekt zbatimit.

2.3.4.10 Dyer, dritare

Projektuesi duhet të përcaktojë që materialet që do të përdoren të jenë të cilësisë së lartë. Nëse janë propozuar dyer prej druri, ato duhet të jenë prej druri të fortë me mentesha të forta (minimumi tre për çdo derë) dhe sipas standardeve të MAS.

Dritaret dhe dyert që janë në kontakt me ambientin e jashtëm do të jenë prej duralumini, me dopio xham, me një xham termik në pjesën që ka kontakt me ambientin jashtë.

Vendosja e dyerve dhe plani i hapjes së tyre të realizohet i tillë që të plotësojë kushtet e daljes së shpejtë në raste emergjencash (me hapje nga korridori) dhe standardet e vendosura nga MAS.

Përsa i përket dritareve do të jenë duralumini të cilësisë së lartë me hapje me rrotullim dopio-xham dhe me sopralluce në ambiente që e kërkojnë atë. Gjithashtu për katet e para duhet të jetë të parashikuara të gjitha normat e sigurisë, pra edhe pajisja e tyre me elementet metalike mbrojtës përkatës.

2.3.4.11 Kalimet e emergjencës, shkallët, korridoret

Konsulenti duhet të parashikojë dhe kalimet e emergjencës (shkallët, korridoret). Numri dhe gjerësia e kalimeve të emergjencës duhet të sigurojnë largimin sa më të shpejtë dhe shfrytëzimi i tyre të nxjerrë në vend të sigurt jashtë ndërtesës me një rrugë të shkurtër, të shpejtë dhe pa rrezik.

Për përcaktimin e gjerësisë dhe gjatësisë së rrugëve të emergjencës, faktori kryesor është kohëzgjatja e largimit të personave nga objekti. Koha maksimale e largimit nga objekti në sekonda për çdo dhomë, mbas dhënies së sinjalit të alarmit duhet të jepet e llogaritur nga projektuesi.

Materiali për planet e evakuimit në rast emergjencash do të merren nga Bashkia Elbasan.

2.3.4.12 Ambientet sanitare

Në bashkëpunim me stafin mësimor, konsulenti duhet të parashikojë ambiente higjeno- sanitare të përshtatshme për nxënësit e grupmoshës, 15 deri 18 vjeç.

Nyjet sanitare të jenë të veçanta dhe lavamanët të jenë të mjaftueshëm për numrin e nxënësve. Të sigurohet ujë i vazhdueshëm dhe i ngrohtë në lavamanë, për këtë arsye të shikohet mundësia e instalimit të boliereve, si dhe realizimi i rrjetit të nevojshëm hidraulik në rast se vlerësohet e nevojshme.

Banja dhe parabanja të jenë të ajrosura, të ndriçuara dhe të ventiluar. Në rast se s'ka ajrim direkt duhet të pajisen me impiant ajrimi dhe ventilimi. Kollonat e shkarkimit të jenë të shkëputura nga kanalet e ventilimit, me ajrim të jashtëm dhe shkarkimet të jenë të kontrollueshme.

Banjat të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja dhe të përjashtohet hapja nga brenda, për raste emergjence.

Për katin përdhe duhet të ofrohen sipas standardeve kushte për akses në nyjet higjeno-sanitare për personat me aftësi të kufizuara (PAK).

2.3.4.13 Ambientet sportive

Për terrenet e jashtme sportive ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit, pasi në periudhat e reshjeve këto ambiente bëhen me baltë, sepse është tokë natyrore, pa kushtet e duhura për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik. Terrenet e jashtme sportive kanë nevojë për sistemim sipas standardeve.

2.3.4.14 Sistemimet e jashtme dhe ambientet e gjelbëruara

Sistemimit të oborrit të shkollës duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë. Ai duhet të rezultojë me rrethim transparent (kangjella, etj) dhe të garantojë të gjitha normat e sigurisë dhe standardeve për ndërtime të këtij lloji. Ambientet e jashtme janë ambiente që kryesisht shërbejnë për qëndrim, çlodhje prandaj rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i një sipërfaqeje të gjelbër dhe me pemë. Projektuesi duhet të japë të detajuara shtresat përkatëse dhe teknologjinë e zbatimit të tyre, dhe të kombinojë ambientet e qëndrimit/rreshtimit me ambientet e gjelbëruara.

Konsulenti duhet t'i jap rëndësi dhe të parashikojë dhe ndriçimin e jashtëm të objektit, në përputhje me planin e zhvillimit të territorit të kësaj zone dhe në përputhje me kërkesat e veçanta për rrjetin e ndriçimit të dhënë në këtë detyrë projektimi.

Për të mbajtur pastërtinë e oborrit të shkollës, në projekt/preventiv të parashikohet vendosja e koshave për mbeturinat, sidomos në afërsi të stolave.

T'i kushtohet kujdes i veçantë, sistemimit dhe disiplinimit të ujërave sipërfaqësore të cilat janë problematike për këtë objekt.

2.3.5 Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të merren parasysh sa më poshtë:

- Të merret në konsideratë perspektiva 10-vjeçare e rritjes së numrit të fëmijëve për kapacitetin maksimal të shkollës. Të merret në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonave ku ndodhen objektet, por gjithashtu konsulenti duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona, nëse ka.

- Drejtimi i zhvillimit të territorit të zonës do të merret në Bashki.

Sistemi i largimit të ujërave të bardha dhe të zeza do të jetë miks.

Në përputhje me normat, konsulenti duhet të ketë parasysh numrin e fëmijëve, stafin mësimor dhe administrativ.

Konsulenti duhet të verifikojë gjendjen teknike të nyjeve higjeno-sanitare ekzistuese dhe duhet të përgatisë projektin e detajuar si për rikonstruksionin e atyre ekzistuese ashtu edhe të shtesës eventuale të kapacitetit (numrit) të tyre.

Zgjidhja dhe rinovimi me gropa septike të shihet si një zgjidhje e përkohshme, me perspektivën e lidhjes me rrjetin e shkarkimit të ujërave të zeza që mund të ndërtohet në bashkëpunim me UKE me materiale bashkëkohore dhe në përputhje me standardet në fuqi.

Rrjeti i amortizuar i ujësjellësit do të zëvendësohet.

Materialet që do përdoren për rrjetin e brendshëm të ujësjellësit do jenë tuba polietileni me densitet të lartë për ujë të pijshëm me diametër dhe aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Për nyjen e marrjes nga rrjeti i zonës do të parashikohet puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Nëse është e domosdoshme, projektuesi duhet të parashikojë zëvendësimin dhe nxjerrjen jashtë pune të sistemit të vjetër të furnizimit me ujë.

Projektuesi të parashikojë në projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë nga pika e marrjes së dhënë nga Ujësjellës Kanalizime Elbasan deri tek matësi i ujit.

Të parashikohet realizimi i depozitave të ujit, të nevojshme në raste emergjence, si dhe lidhja e tyre në, me të paktën dy prej lavamanëve dhe nyjeve sanitareve si dhe depozitat e ujit për MNZ.

2.3.6 Rrjeti elektrik, telefonik dhe kompjuterik

Rikonstruksioni i objekteve duhet të përfshijë edhe instalimin e ri elektrik, telefonik dhe vlerësimin në rast se nevojitet për përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit të internetit në laboratorin e informatikës dhe zyrave të administratës.

Konsulenti duhet të parashikojë ndriçimin e ambienteve me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre. Projektuesi duhet të japë detajin e fiksimit të ndriçuesve si dhe dimensionet e elementeve në të cilat ato do të kapen.

Panelet e komandimit të vendosen të rinj sipas standardeve bashkëkohore.

Në këto kushte projektuesi duhet të parashikojë nevojitet dhe instalimin e rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionim normal të sistemit elektrik me të gjitha pajisjet e saj. Projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e matësit elektrik trefazor, dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kabllit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar.

Pozicionimi i ndriçuesve për secilin ambient duhet të përputhet me konceptin arkitekturor të përgjithshëm, në përputhje me funksionin e ambientit dhe standardet kundrejt tij.

Ndriçuesit e propozuar duhet të shmangin elementët e rrezikshmërisë, emetimin e lëndëve të rrezikshme për shëndetin, përdorimin materialeve që shkaktojnë mbetje të dëmshme për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve, duke ofruar dhe konsum energjie ekonomik me llampa LED.

Ndriçimi në ambiente duhet të jetë shplothës dhe plotësojë normativat e detyrueshme nga tipologjia funksionale e tyre. Shpërndarja e ndriçuesve në ambient duhet të përshtatet me kërkesat funksionale të tij, duke ruajtur sipas rastit një shpërndarje të njëtrajtshme të dritës. Kjo zgjidhje duhet gjithsesi të përmbushë kërkesat nominale të ambientit për ndriçim, sipas tipologjisë, pa cënuar konceptin e përgjithshëm të pasqyruar në projektin arkitekturor mbi estetikën, zgjidhjen e tavanëve, mureve dhe hapsirave të punës dhe ndriçimin e përgjithshëm të interierit. Tipologjia, estetika, këndi i hedhjes së dritës dhe gjeometria e secilit ndriçues duhet të përcaktohet në bashkëpunim me projektuesin arkitekt duke mbajtur në konsideratë lartësinë e ambientit dhe tavanëve të varur (në rast se janë propozuar). Drita ideale duhet të vijë në tavolinën e punës me kënd anësor dhe jo pingul. Shkëlqimi i sipërfaqeve duhet të kufizohet.

Pavarësisht referencave më sipër, nisur nga specifikat e veçanta të secilit ambient funksional, mbetet në gjykimin e projektuesit përdorimi i një standardi minimal ndriçimi, ose një tjetri, bazuar në kërkesat e saktësuara për secilin ambient, në përputhje me veprimtarinë dhe proceset e punës, për të cilët është projektuar.

Vendosja e prizave elektrike, Lan, sistemeve audio video etj. duhet të përputhet me hapsirat e punës të propozuara nga arkitekti në projektin e mobilimit.

Në tërësi në hartimin e projektit do të mbahen parasysh këto kërkesa për projektimin dhe zbatimin e rrjetit elektrik dhe elektronik:

- Të gjithë instalimet elektrike, kabllot dhe ndriçuesit, çelësat, prizat etj. duhet të jenë hermetikë.
- Ndriçimi elektrik duhet të zbatohet sipas normat e CE.
- Sistemi elektronik duhet të konceptohet me server (servera) qendror të veçantë.
- Në projektin elektrik duhet të parashikohet edhe instalimi i ndriçimit të emergjencës, në rastet e shpërthimeve të rrymës, apo emergjence të çfarëdo lloji.
- Në ndërtesë duhet të parashikohen sisteme elektrike dhe elektronike të nevojshme për mirëfunksionimin e ndërtesës. Krahas sa më sipër, të shqyrtohet **mundësia e integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë**.
- Projekti elektrik të jetë i shoqëruar me licencën e inxhinierit elektrik. Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe llambat me bateri të karikueshme, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.
- Projekti duhet të përmajë rrjetin e ndriçimit, ku përfshihet edhe ndriçimi i ambienteve të jashtëm dhe ndriçimi i emergjencës, rrjetin e prizave të furnizimit me energji, të prizave të UPS, rrjetin e furnizimit me energji elektrike nga OSHEE, sistemin e telefonisë, rrjetit LAN, sinjalizimit të zjarrit, sistemin video, acces-control, sistemin e vëzhgimit me kamera, sistemin e rrufeprirjes etj., në harmoni me kërkesat e projektit arkitekturor.

2.3.7 Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe siguri

Dhoma e transformatorit duhet të jetë e izoluar nga dhomat e tjera me mur zjarrdurrues dhe nuk duhet të ketë lidhje me kalimet e emergjencës.

I gjithë sistemi elektrik duhet të jetë i tillë që të stakohet në një pikë të vetme në katin përdhe, e cila mund të arrihet lehtë dhe të ketë shenjat dalluese përkatëse. Skema elektrike e ndriçimit dhe e fuqisë duhet të jetë e afishuar në panelin e stakimit.

Nuk lejohet që tubacionet e sistemeve të tjera (ngrohjes, ujit të ngrohtë etj) të vendosen në të njëjtin kanal.

Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni. Ndriçimi i emergjencës dhe i sigurisë duhet të vendoset në ambientet e mëposhtme:

- *Korridore, të cilat shërbejnë edhe si rrugë largimi emergjence;*
- *Në shkallë deri në largimin nga objekti;*
- *Dhoma që shërbejnë si salla mbledhjesh;*
- *Në ambientet që nuk kanë dritare;*
- *Në të gjitha dhomat e furnizimit me energji (gas, elektricitet etj).*

2.3.8 Sistemi i mbrojtjes atmosferike

Shkollat duhet patjetër të kenë sistemin e mbrojtjes atmosferike pasi Shqipëria gjendet në një zonë me shkarkime atmosferike të shumta.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike duhet të bëhet duke u bazuar në kushtet teknike të përcaktuara dhe në specifikimet e materialeve të ndërtimit.

2.3.9 Sistemi ngrohës dhe i ventilimit

Konsulenti duhet të parashikojë ndërtimin e plotë të sistemit ngrohës (ngrohje qendrore) duke argumentuar nga ana tekniko – ekonomike zgjedhjen e mënyrës së ngrohjes, por njëkohësisht projekti të sigurojë ventilimin e ambienteve.

Projektuesi duhet të parashikojë instalimin e rrjetit elektrik me fuqi të tillë (tre fazor) që të sigurojë funksionim normal të sistemit të ngrohjes.

Konsulenti të shikojë mundësinë për ndërtimin e një ambienti teknik të veçantë ku të instalohet kaldaja, grupi i pompave, rezervuarët e ujit sanitar dhe ujit për MNZ-në.

Në projekt duhet të jepet qartë dhe e detajuar, vendndodhja e dhomës së kaldajës dhe karakteristikat e saj, vendodhja e rezervuarit të naftës/ambienti i depozitimit të peletit, të cilat duhet të jenë në pozicion të tillë që të furnizohen lehtë me lëndë djegëse, dimensionet dhe lloji i tubacioneve, kolektorëve, radiatorëve që do të përdoren, të gjitha llogaritjet e bëra si edhe detajet e nevojshme së bashku me specifikimet teknike përkatëse për fazën e projekt zbatimit.

Në dhomën e kaldajës të parashikohet një dritare e hapshme, ose grilë e cila do të shërbejë për ajrimin e dhomës nga gazrat e krijuara, si dhe të parashikohet ventilimi mekanik (aspirator) i tij dhe instalimi i një lavamani.

Në llogaritjet për kapacitetin e rezervuarit të naftës, konsulenti duhet të marrë në konsideratë se gjatë sezonit të dimrit furnizimi nga Bashkia kryhet *dy deri në tre herë* me lëndë djegëse. Në rastin e

sistemit të ngrohjes me peletë, projektuesi duhet të parashikojë ambientin e depozitimit të lëndës djegëse të tillë që të sigurojë një nivel lagështie jo më shumë se 10 %.

2.3.10 Sistemi i mbrojtjes nga zjarrit (MNZ)

Konsulenti duhet të paraqesë dhe projektin e mbrojtjes nga zjarri, si dhe rregullat e sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standardeve evropiane.

Kërkohet të zgjidhet me mundësinë për vendosjen e shkallëve të emergjencës dhe kafaz metalik rrethues.

Sistemi i lajmërimit për zjarrin

Në objekt të shikohet mundësia e një kabinë telefonike që të mund të përdoret në çdo moment. Numrat e telefonit të zjarrfikësit duhet të jenë të afishuar dukshëm në këtë kabinë.

Ndërtesa duhet të ketë gjithashtu sistemin e brendshëm të alarmit, nëpërmjet të cilit në rast rreziku të bëhet largimi nga ndërtesa.

Sinjali i alarmit duhet të transmetohet në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jetë i qartë dhe i kuptueshëm nga të gjithë. Sistemi i alarmit duhet të futet në punë pavarësisht nga furnizimi me energji elektrike i objektit.

Sinjalizuesit e tymit

Këto do të veprojnë në mënyrë që të mbajnë ekuilibrin ndërmjet dhomës së hapur dhe të mbyllur, kështu kur tymi depërton në dhomën e hapur ai do të ketë kontakt me qarkun dhe do të aktivizojë sinjalin.

Të gjithë sinjalizuesit e tymit, të jenë instaluar të tilla që të mund të ndërrohen me zëvendësues.

Bombulat fikëse të zjarrit

Bombulat fikëse (me shkumë ose pluhur) duhet të vendosen në korridore dhe në ambientin teknik.

2.3.11 Raporti dhe auditimi i efikasitetit energjetik

Mbështetur në VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 (hyrja në fuqi 21.05.2015) "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e azhurnuar, pjesë e dokumentacionit për marrjen e Lejes së Ndërtimit duhet të jetë edhe projekti i efikasitetit energjetik, në rastet kur është e detyrueshme me ligj.

Pjesë e dokumentacionit të projektimit duhet të jetë edhe Raporti mbi efikasitetin e energjetik të ndërhyrjes së propozuar. Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për efikasitetin e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

Kur projektohet një ndërtesë e re ose kur një ndërtesë duhet t'i nënshtrohet një rinovimi të rëndësishëm, subjekti që ka apo do të ketë në pronësi apo përgjegjësi administrimi këtë ndërtesë, duhet të marrë në konsideratë zbatimin e kërkesave të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë së ndërtesave dhe të analizojë mundësinë e përdorimit të sistemeve me një

performancë të lartë të energjisë, të parashikuara ne Ligjin 116/2016 "PËR PERFORMANCËN E ENERGIJË SË NDËRTESAVE" neni 8 e vijues.

Hartimi i propozimeve të zgjidhjeve teknike në respektim të kriterëve të efikasitetit energjetic të ndërtesës së parashikura, duhet të kryhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, me qëllim që në të gjithë projektet specifike të mbahen në konsideratë kriteret e efikasitetit energjetic, për arritjen e një performancë sa më të mirë energjeticë të të gjithë ndërtesës.

Hartimi i Raportit të efikasitetit energjetic duhet të kryhet në përputhje me metodologjinë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa, sipas nenit 5 të Ligjit 116/2016 më sipër cituar.

Gjatë procesit të projektimit duhet paraprakisht të kryhet vlerësimi i mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjetic. Gjatë vlerësimit teknik të mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjetic, duhet të merren në konsideratë çështjet mjedisore dhe ekonomike.

Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për efikasitetin e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

2.3.12 Kërkesat teknike kundrejt shërbimit të VNM

Në rast nevojë referuar legjislacionit përkatës në fuqi, nga vlerësimi sipas ndërhyrjeve që ofron projektuesi, Raporti i VNM/VNM do të mundësohet nga Bashkia Elbasan.

- Kërkesa të veçanta

Në realizimin e projektit të rikonstruksionit, si dhe atij të mirëfillteë arkitektonik duhen patur parasysh dhe te gjejnë zbatimin e duhur të gjitha rregullat dhe normat urbanistike dhe arkitektonike për personat me aftësi të kufizuar PAK.

Projektuesi duhet të parashikojë në projekt/preventiv edhe rampat për lëvizjet e fëmijëve me aftësi të kufizuar (PAK), sinjalistika për të verbërit, etj.

- Projektuesi gjithashtu duhet të sigurojë azhurnimin e rrjeteve inxhinierike të infrastrukturës për objektin nga institucionet kompetente.
- Dokumentacioni ligjor që shoqëron dosjen e paraqitur për leje ndërtimi sipas formularëve përkatës, (përveç konfirmimit të pronësisë së objektit, azhurnimit topografik, pagesat për certifikatën e performancës së energjisë në Agjencinë e Efikasitetit të Energjisë, Oponencën Teknike në Institutin e Ndërtimit, kërkesat teknike kundrejt shërbimit të VNM, vlerësuar sipas ndërhyrjeve që ofron projekti) që do të sigurohen nga bashkia), do të përgatiten nga vetë projektuesi.

3. HARTIMI I PREVENTIVIT

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve në fuqi. Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do t'i bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas çmimeve të V.K.M nr. 616, datë 13.04.2023.

4. STANDARDET

4.1 Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuara, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

4.2 Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihet parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji "Për planifikimin e territorit".

5. REALIZIMI I PROJEKTIT

Projekti i paraqitur për Rikonstruksionin e Shkollës "Anastas Çakalli" duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 "Për Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Terriori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim" për dokumentacionin përkatës:

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit të objektit "Rikonstruksion i Shkollës Anastas Çakalli" me përmbajtjen si më poshtë:

- *Raporti Teknik;*
- *Projektin arkitektonik: Relacion arkitektonik i objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i mbulesës, etj;*
- *Projektin e zbatimit/konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.*
- *Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve;*

- *Projekt Zbatimin e instalimeve elektrike, të shoqëruara me licencën e projektuesit;*
- *Projekt Zbatimin e instalimit të sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit;*
- *Projektin e sistemit dhe të gjelbërimit të oborrit, projektin e ambienteve të lojrave;*
- *Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;*
- *Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;*
- *Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren;*
- *Relacionin gjeologjik për shtesat e reja të parashikuara;*
- *Raportin e Ndikimit në Mjedis (vlerësuar në rast nevojë me Bashkinë sipas kriterëve për leje ndërtimi);*
- *Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut;*
- *Analizat teknike të çmimeve të zërave të punime që nuk janë në manual;*
- *Planin e organizimit të punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve që do jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur në grafikun e punimeve;*
- *Licencë të firmës projektuese, licencë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrimit tregtar.*
- *Raporin e auditimit të energjisë për objektin e projektit teknik;*
- *Deklaratat e përgjegjësisë profesionale për secilin ekspert kryesor (arkitekt, inxhinier konstruktor, inxhinier mekanik, auditues energjetik, inxhinier elektrik, etj) që nënshkruan projektin;*
- *Policat e sigurimit për secilin ekspert kryesor (arkitekt, inxhinier konstruktor, inxhinier mekanik, auditues energjetik, inxhinier elektrik, etj) që nënshkruan projektin.*

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet shkolla. Sistemin ekzistues të largimit të ujërave, Sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, Sistemin ndriçues rrugor, distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Elbasanit, seksioni i urbanistikës dhe nga kadastra e asetet.
- Konsulentit do t'i vihet në dispozicion edhe një Program Standard i ambienteve ku janë përcaktuar standardet minimale të organizimit të hapësirave të brendshme, lloji i ambienteve të detyrueshme, instruksione mbi funksionet që duhet të akomodohen, sipërfaqet funksionale të rrethimeve dhe sistemeve të jashtme, etj.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë:

- *Plani i vendosjes së strukturës i cili do të hartohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Projekteve dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit) pranë Bashkisë së Elbasanit.*
- *Licencë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të Regjistrimit Tregtar.*
- *Licenca të inxhinierëve projektues, licenca të ekspertit mjedisor + deklarata noteriale të inxhinierëve projektues.*
- *Projekti i plotë elektrik (planvendosjen e të gjitha pajisjeve elektrike, sistemi data - telefoni, projekti i MNZ, i mbrojtjes atmosferike dhe tokëzimit) të printuara në formatin A3, shkalla 1:1000 në 4 kopje origjinale;*
- *Kopja e licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektin (në 4 kopje);*
- *Planvendosja e objektit në shkallën 1 : 1000 format A3 (kopje origjinale);*

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Elbasanit. Studio e licencuar (e pajisur me NIPT dhe QKB) për projektim duhet të ketë të punësuar të paktën 3 punonjës, ku një prej tyre të jetë arkitekt, dhe pjesa tjetër e specialistëve të nevojshëm për hartimin e projektit teknik mund të realizohet me ekspertë të jashtëm të dakordësuar mes tyre sipas legjislacionit përkatës.

Secili ekspert, pjesëtar i Grupit të Projektimit, duhet të ofrojë një shërbim profesional dhe të ketë kualifikimin e nevojshëm për kryerjen e këtij shërbimi. Për secilin ekspert do të paraqiten CV-të dhe licencat përkatëse.

Stafi që kërkohet duhet të mbulojë:

- Arkitekt;
- Inxhinier ndërtimi (i specializuar në fushën e projektimit të strukturave).
- Inxhinier ndërtimi (i profilit hidroteknik);
- Inxhinier për sistemet e ngrohjes;
- Inxhinier elektrik/elektronik.;
- Auditues energjetik.

Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

Për këtë fazë të punës, duhet të përgatitet dokumentacioni tekniko - ligjor përkatës, në përputhje me kërkesat ligjore, me qëllim plotësimin e dosjes për marrjen e lejes së ndërtimit, sipas tipologjive të lejeve. Përmbajtja e dosjes për leje ndërtimi përcaktohet nga legjislacioni në fuqi. Këtu përfshihet përgatitja e dosjes për projektin teknik, përgatitja e dosjes për kryerjen e oponencës teknike, dokumentacioni për marrjen e pëlqimit mjedisor në rast nevojë, dokumentacioni për marrjen e certifikatës së auditimit energjetik.

6. KOHËZGJATJA E KRYERJES SË SHËRBIMIT

Periudha e fillimit

Data e parashikuar e fillimit për ofrimin e shërbimeve do të jetë data e përcaktuar në kontratën e shërbimit.

Periudha e përfundimit e parashikuar, ose kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shërbimit do të përcaktohet në ditë kalendarike në kontratën mes palëve. Kjo kohëzgjatje shërbimesh është parashikuar për shërbimin e kërkuar. Kjo kohëzgjatje është parashikuar për përgatitjen e projektit sipas fazave dhe dokumenteve të kërkuara në pikën 5.

Duhet të theksohet se kohëzgjatja e përgjithshme e hartimit të projektit ka të bëjë me dorëzimin e dokumentacionit pranë Porositësit. Grupi i Projektimit duhet të jetë i gatshëm të angazhohet për plotësimin, dorëzimin dhe mbrojtjen e projektit sipas kërkesave të institucioneve lejuese, me qëllim marrjen e lejeve të nevojshme për zbatimin e tij.

Grupi i projektimit duhet të konsiderojë se takimi fillestar do të organizohet me pjesëmarrjen e ekipit projektues, grupit të hartimit të detyrës së projektimit dhe përfaqësuesve të përfituesve.

Drejtuuesi i ekipit të projektimit do të jetë përgjegjës për organizimin e takimeve dhe koordinimin e procesit të projektimit. Grupi i Projektimit duhet të paraqesë planin e punës për të siguruar përdorimin efikas të burimeve dhe për të përshatur kërkesat aktuale të punës me kërkesat paraprake.

7. RAPORTIMI

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe ku të paktën dy nga kopjet të jenë të printuara me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin "dwg" (AutoCad 2016-2022). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 2 CD).

- Të gjithë raportet do të dorëzohen në formë fizike dhe në formë elektronike pranë Porositësit, në format të lexueshme. Shkrimet dhe detajet të dallohen qartë.
- Vizatimet dhe raportet e projekt – preventivit të zbatimit duhet të jenë në 4 (katër) kopje origjinale të printuara dhe 2 (dy) CD me të gjitha materialet në formatet përkatëse (autocad, word, excel, etj.).
- Në CD duhet të bashkëlidhen edhe versionet "pdf" të të gjithë materialeve bashkë me nënshkrimin elektronik për çdo profil ekspertit sipas dokumentacionit të nevojshëm për aplikim për leje ndërtimi nga Bashkia Elbasan në sistemin "e-leje".
- Të gjithë dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga të gjithë anëtarët e ekipit të projektimit.

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- *Raportin teknik të projektimit arkitektonik;*
- *Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat që përfshin ndërhyrja (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.) si dhe masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e investitorit.*
- *Relacionin sizmologjik të truallit (kur nuk ka studim, një përshkrim i përgjithshëm);*
- *Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.*

Relacioni gjeologjik dhe vetitë fiziko-mekanike të dherave ku duhet të paraqiten.

- *Cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit ekzistues.*
- *Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.*

8. PARAQITJA E VIZATIMEVE

Vizatimet në fazë projekt zbatimi duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

1. *Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme*
2. *Planvendosja e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500*
3. *Planimetritë e kateve ekzistuese Shk. 1:100, 1:50*
4. *Planimetritë e objektit pas ndryshimeve Shk. 1:100; 1:50*
5. *Fasadat ekzistuese Shk.1:100*
6. *Fasadat e reja në 2D dhe 3D Shk.1:100*
7. *Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100*
8. *Planimetria e themeleve Shk.1:100*
9. *Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10*

10. *Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50*
11. *Planimetritë e mobilimit të shkollës Shk.1:100*
12. *Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkollën Shk. 1: 100*
13. *Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20*
14. *Planimetria e furnizimit me ujë në Shk. 1: 200, 1:100*
15. *Skemat aksonometrike të furnizimit me ujë, detaje të pajisjeve hidrosanitare Shk.1:100*
16. *Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10*
17. *Planimetria, aksonometria dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100*
18. *Planimetria dhe detaje të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100*
19. *Planimetria e dhomës së kaldaçës, konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50*
20. *Planimetri dhe detaje për ndriçimin, fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50*
21. *Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objektin, Shk. 1:100*
22. *Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50*
23. *Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50*
24. *Planimetria e ambienteve sportive dhe ambienteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50*
25. *Planimetria e murit rrethues, tipin dhe detajin e fiksimit të stolave Shk.1:100; 1:50.*
26. *Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50.*

9. PREVENTIVI

Grupi i Projektimit duhet të paraqesë detyrimisht preventivin përfundimtar të punimeve. Çdo zë i këtij preventivi duhet të mbështetet në Klasifikimet Ligjore të Kostove dhe Analizat Teknike të Çmimeve nga Manualet Teknike përkatëse, në përputhje me VKM në fuqi (V.K.M nr. 616, datë 13.04.2023). Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale, të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut duke marrë tre oferta nga operatorë ekonomike, që operojnë në vendin tonë (oferta që do të bëhen pjesë e dokumentit të dorëzuar). Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndarë sipas kategorive dhe zërave të punës.

Harmonizimi dhe koordinimi i kategorive të punës së projektit të bëra nga specialistët e përfshirë në planifikimin e projektit, përfshirë fondin rezervë dhe T.V.Sh. 20 %.

10. INVESTIMI THEMELOR

Projekti teknik do të aprovet nga Europartners Development si aplikues i grantit të UNICEF Albania për programin "Infrastruktura shkollore" dhe nga Bashkia e Elbasanit.

Duke marrë në konsideratë investime të ngjashme nga bashkia Elbasan, vlera e përlogaritur paraprake për këtë investim për zbatim është rreth **112,742,000** (njëqind e dymbëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e dymijë) lekë (me TVSH).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

GLEDIAN LLATJA



DETYRË PROJEKTIMI

“Rikonstruksioni i Shkollës "Abdyl Paralloi"”

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	2
1.1	Institucioni përfitues	2
1.2	Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje	2
1.3	Baza ligjore	2
1.4	Qëllimi i projektit të investimit	3
1.5	Objektivat e projektit të investimit.....	3
2.	PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT	3
2.1	Qëllimi	3
2.2	Objektivat.....	4
2.3	Përshkrim i përgjithshëm	4
2.3.1	Pozicionimi i parcelës që zhvillohet	4
2.3.2	Gjendja faktike	5
2.3.3	Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor	9
2.3.4	Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv	11
2.3.5	Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve	14
2.3.6	Rrjeti elektrik, telefonik dhe kompjuterik	15
2.3.7	Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë.....	16
2.3.8	Sistemi i mbrojtjes atmosferike.....	17
2.3.9	Sistemi ngrohës dhe i ventilimit.....	17
2.3.10	Sistemi i mbrojtjes nga zjarrit (MNZ).....	18
2.3.11	Raporti dhe auditimi i efencës energjitike.....	18
2.3.12	Kërkesat teknike kundrejt shërbimit të VNM	19
3.	HARTIMI I PREVENTIVIT	19
4.	STANDARDET	20
5.	REALIZIMI I PROJEKTIT	20
	<i>Rekomandime për projektuesin</i>	<i>21</i>
	<i>Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar.....</i>	<i>22</i>
6.	KOHËZGJATJA E KRYERJES SË SHËRBIMIT.....	22
7.	RAPORTIMI.....	23
8.	PARAQITJA E VIZATIMEVE.....	23
9.	PREVENTIVI.....	24
10.	INVESTIMI THEMELOR.....	24

1. HYRJE

1.1 Institucioni përfitues

Institucioni përfitues i shërbimit në fushën e projektimit është Bashkia Elbasan. Përfituesi i këtij shërbimi është Institucion Publik.

Misioni i këtij institucioni është:

- Të sigurojë një shërbim arsimor sa më të mirë, të drejtë, transparent dhe gjithëpërfshirës për çdo nxënës, të shkollës 9-vjeçare dhe kopësht "Abdyl Paralloi".

Vizioni "Elbasani, qyteti i fëmijëve".

Bashkia Elbasan zhvillon aktivitetin bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë në tërësi dhe legjislacionin e posaçëm për institucionet e arsimit parauniversitar në veçanti.

Përfituesit parësorë janë komuniteti i nxënësve që ndjekin arsimin në këtë shkollë, si dhe stafi pedagogjik i nivelit arsimor të kësaj shkolle.

Përfituesit e tërthortë janë prindërit e nxënësve që ndjekin arsimin në këtë shkollë si dhe komuniteti i banorëve të zonës përreth, si rritje e cilësisë së infrastrukturës së zonës urbane, por dhe mundësi për zgjedhje si shkollë me standarde për brezat e rinj pasardhës.

Nga realizimi i tij do të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë 323 nxënës, prej të cilëve 9 fëmijë me aftësi të kufizuar, 46 fëmijë romë dhe 110 fëmijë egjiptianë, 27 mësues, si dhe në mënyrë të tërthortë 646 prindër e komuniteti përreth.

1.2 Arsyetimi i nevojës për ndërhyrje

Sipas vlerësimit teknik, shkolla ka nevojë për Rikonstruksion Tipi A. Punimet kryesore të rikonstruksionit të ndërtesës kanë të bëjnë me: rinovim total të pllakave të dyshemeve pasi janë të vjetra që nga viti i ndërtimit; rinovim të suvatimeve të brendshme dhe jashtme të amortizuara nga lagështia; lysterje totale brenda dhe jashtë me bojë hidroplastike; rinovim total të dritareve, dyerve të brendshme dhe derës së jashtme të shkollës; rinovim të sistemit elektrik të shkollës, përfundim të fuqisë së rrjetit, rinovim të prizave dhe çelësave; rinovimin e shtresave të hidroizolimeve të tarracës; riparim të ulluqeve; rinovim të dyshemesë të palestrës së brendshme si dhe disa riparime të suvave dhe lysterje të mureve; ndërtim të një terreni sportiv jashtë sipas standardeve.

1.3 Baza ligjore

Bazuar në statusin ligjor të institucionit, ky shërbim në fushën e projektimit duhet të përmbushë kërkesat dhe të marrë në konsideratë referencat si vijon:

1. Ligj nr. 107, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
2. Ligj nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë";
3. Ligj nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
4. Ligj nr. 116/2016, "Për performancën e energjisë në ndërtesa";
5. VKM nr. 408, "Rregulloren e Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar;

6. VKM nr.1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapsirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar””;
7. VKM nr. 319, datë 12.04.2017, “Standardet për projektimit e shkollave”;
8. VKM nr. 98, datë 06.02.2013, “Për miratimin e listës së standarteve të harmonizuara shqiptare”;
9. VKM nr. 68, datë 15.02.2001, “Për miratimin e standardeve dhe kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit”;
10. “Rregullore për formatin e auditimit energjitik dhe pagesën e audituesit energjitik”, miratuar me Urdhër nr. 5, datë 12.01.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë;
11. Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore, normat dhe standardet, miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
12. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Elbasan, miratuar me Vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016, i rishikuar;
13. Manualët, standardet dhe kushtet teknike shtetërore dhe evropiane normat ISO të projektimit të objekteve arsimore;

1.4 Qëllimi i projektit të investimit

Qëllimi i rikonstruksionit është “Të përmirësohet infrastruktura arsimore në Elbasan nëpërmjet ndërhyrjes infrastrukturore, si bazë për aplikimin e kushteve ndërtimore që sigurojnë standarde kombëtare për nxënësit dhe mësuesit, familjen dhe komunitetin, respektimin e të drejtave dhe përgatitjen e duhur të brezave të rinj të arsimuar”.

1.5 Objektivat e projektit të investimit

Objektivi kryesor i këtij projekti është të sigurojë ambiente të projektuara dhe të përshtatura në përputhje me kërkesat dhe nevojat e veprimtarisë së arsimit 9-vjeçar, në respektim të standardeve bashkëkohore infrastrukturore dhe çdo akti juridik, normativ, apo standard në fushën e projektimit të ndërtesave arsimore në Republikën e Shqipërisë.

Objektivat specifike të këtij projekti investimi përmbledhen në vazhdim:

- Përshtatshmëria funksionale e mjediseve dhe zonimi hapësinor i tyre, në përputhje me kërkesat dhe standardet infrastrukturore për objektet arsimore parauniversitare dhe veprimtarinë institucionale të shkollës 9-vjeçare.
- Plotësimi i mjediseve me sisteme, pajisje, rrjete dhe materiale ndërtimore bashkëkohore.
- Përbushja e kriterëve infrastrukturore për eficientë energjitike, komoditetin termoakustik, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat higjieno - sanitare dhe përshtatjen e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara.
- Sistemimi i mjediseve të jashtme në përputhje me kërkesat për mjedise rekreative, kërkesat drenazhimin e ujërave të shiut, ato për mbrojtjen e mjedisit dhe kriteret për orientimin e fluksit të nxënësve dhe mësuesve të shkollës.

2. PËRSHKRIM I DETYRËS SË PROJEKTIMIT

2.1 Qëllimi

Detyra e Projektimit ka për qëllim parashtrimin e të dhënave thelbësore, njohëse, kërkesave dhe nevojave specifike të institucionit përfutur, në cilësinë e Porositësit, kundrejt shërbimit të kërkuar, si

dhe orientimet mbi problematikën aktuale të shtruar për zgjidhje, mbi bazën e të cilave, grupi i projektimit, do të hartojë projektin për “Rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare dhe kopësht "Abdyl Paralloi"”.

2.2 Objektivat

Detyra e projektimit ka këto objektiva:

1. Të prezantojë grupin e projektimit me vendndodhjen, infrastrukturën dhe problematikën e gjendjes faktike të objektit që i nënshtrohet ndërhyrjes.
2. Të përshkruajë kërkesat sasiore dhe cilësore kundrejt shërbimit të porositur.
3. Të evidentojë kërkesat profesionale kundrejt grupit të projektimit.
4. Të shtjellojë formën, mënyrën dhe afatet e raportimit të materialeve pranë Porositësit.

2.3 Përshkrim i përgjithshëm

2.3.1 Pozicionimi i parcelës që zhvillohet

Parcela, në të cilën ndodhet objekti i cili i nënshtrohet ndërhyrjes, së parashikuar nëpërmjet kësaj detyre projektimi, ndodhet pranë qendrës së qytetit të Elbasanit, rreth 680 m nga Sheshi "Gensher", dhe ndodhet në rrugën "11 Nëntori", përballë me shkollën e mesme "Luigj Gurakuqi", ose ndryshe e njohur si shkolla pedagogjike, si dhe mbrapa kufizohet nga Fakulteti i Shkencave të Edukimit, në parcelën kadastrale me nr. pasurie 10/8, në zonën kadastrale 8521. Topografia e zonës është e rrafshët.



Figura 1. Foto e fasadës kryesore të shkollës

Detyrë Projektimi - Rikonstruksioni i Shkollës "Abdyl Paralloi"



Figura 2. Pozicioni i objektit në hartë kadastrale - plan rilevimi

2.3.2 Gjendja faktike

Analiza e gjendjes faktike të parcelës dhe objektit. Analiza e problematikës që sjell nevojën e investimit dhe kërkesave të shtjelluara në vijim.

Shkolla është e ndërtuar në vitin 1968, por nuk cilësohet si objekt me tipare historike. Sipërfaqja e territorit është 4380 m². Në të ndodhet godina kryesore 3 katëshe, 11 m e lartë, me një sipërfaqe totale 2095 m², ku gjurma e objektit është 698 m². Shkolla mbulohet me tarracë të sheshtë. Godina cilësohet me një kapacitet mbajtës 525 nxënës. Me një numër total prej 21 klasa.

Ndërtesa e shkollës cilësohet e sigurt për jetën. Ajo ka strukturë me muraturë mbajtëse me elementë (kolona, mure, trarë, soleta, themele) në gjendje të mirë dhe funksionale.

Ndërtesa e shkollës ka strukturë me muraturë mbajtëse me elementë (kolona, mure, trarë, soleta, themele) në gjendje të mirë dhe funksionale. Muret e jashtëm janë 45cm dhe muret e brendshëm 30cm.



Figura 3. Foto e portës së shkollës



Figura 4. Foto të oborrit të shkollës

Shkolla ndodhet buzë një rruge të gjerë, me trotuare në të dyja krahët, me gjerësi 22 m, lehtësisht e aksesueshme nga automjetet dhe këmbësorët. Prona e shkollës është e mjaftueshme për të përmbushur të gjitha nevojat e një procesi normal mësimor. Trualli i shkollës mundëson hapësirat e duhura për terrene sportive, zona rekreative dhe qarkullimi dhe gjelbërimi, pavarësisht se i mungon palestra. Rrethimi i shkollës bëhet nëpërmjet mureve dhe kangjellave metalike. Hyrja dhe aksesimi në shkollë bëhet nëpërmjet një porte, por e pa aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara.

Shkolla, aktualisht ka hapësira dhe terrene të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha nevojat e saj për një proces mësimdhënie të mirë. Sipërfaqja e klasave dhe distancat/këndet e fushës së shikimit janë sipas standardeve. Orientimi është Veriperëndim-Juglindje. Drita natyrale për klasat është e mirë. Në kohë të vrenjtur, klasat nuk kanë ndriçim të mirë natyral pasi bllokohen nga godinat përreth shkollës. Shkolla është qendër komunitare. Klubet e saj janë: Klubi i gjuhës rome, klubi i teatrit, klubi i gazetarisë, klubi i fizikës, klubi i gjeografisë.

Mungon ndriçimi i oborrit dhe pjesërisht drejtimi i dritës natyrale në ambientet e brendshme.

Sipërfaqja e një klase tip është:

$5.1\text{m} * 7.8\text{m} = 40\text{m}^2$ Klasë për numër nxënësish: 26nxënës.

Sipërfaqet e klasave nuk janë brenda standardeve të VKM nr. 319, për shkollat e një zone urbane, por duke marrë në konsideratë numrin e nxënësve që kjo shkollë ka, sipërfaqet janë të mjaftueshme. (mesatarisht 20 nxënës në një klasë).

Zona sportive jashtë ka një fushë për volejball, basketboll, futboll.



Figura 5-7. Foto të korridorit hollit dhe shkallëve të shkollës

Shkolla ka sallë mësuesi, drejtori, nëndrejtori, zyrë për mësuesit e edukimit fizik, laborator TIK (2 laptopë dhe 10PC nga fondacioni Soros, por vetëm 2 PC janë funksionalë) dhe disa anekse për bazën materiale të kimisë, biologjisë, fizikës. Mungon një sallë e dedikuar për aktivitete shumëpërdorimshme. Biblioteka është jashtë standardeve.

Godina nuk ka nevojë për izolim akustik, pasi muret janë shumë të trasha dhe nuk e përcjellin tingullin. Dritaret janë izoluese të këqija, por zona ku ndodhet shkolla është shumë e qetë dhe nuk ka ndotje akustike.



Figura 8-9. Foto të bibliotekës së shkollës



Figura 10. Foto të një klase mësimi



Figura 11. Foto të drejtorisë



Figura 12-14. Foto të mureve dhe tavanit me probleme lagështie

Ndërtesa ka nevojë urgjente për hidroizolim. Në klase dhe tualete ka gjurmë lagështie dhe probleme në suva. Në dimër, ndihen aroma të pakëndshme në klase.

Tualetet janë funksionale, por janë në gjendje shumë të keqe dhe kanë nevojë për rinovime. Dyert dhe pllakat janë të dëmtuara, shkarkuesit dhe tubacionet janë me probleme. Mungojnë rubinetat.



Figura 15-18. Foto të nyjeve higjeno-sanitare



Figura 15. Foto të mureve të fasadës me probleme lagështie

Godina nuk ka nevojë për izolim akustik, pasi muret janë tulle, 45 cm dhe nuk e përcjellin tingullin. Dritaret janë duralumini me xham tek dhe izoluese të këqija, dhe zona ku ndodhet shkolla ka ndotje akustike. Dyert e brendshme janë dyer druri. Shkolla ka panele fotovoltaike.



Figura 16. Foto të sistemit të prodhimit të energjisë me panele fotovoltaike

Kërkesat teknike planimetriko – kompozicionale dhe infrastrukturore

Hartimi i projekteve specifike, të shtjelluar në vijim, duhet të mbështetet në studimet e thelluara të gjendjes faktike. Çdo dokument teknik që disponohet nga institucioni në shërbim të procesit të projektimit do t'i vendoset në dispozicion grupit të projektimit. Grupi i projektimit duhet të hartojë projektin mbështetur në konstruksionin e ndërtesës ekzistuese, pa anashkaluar kriteret për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e efikasitetit energjetic.

2.3.3 Kërkesat teknike kundrejt projektit arkitekturor

Me qëllim rritjen e efikasitetit energjetic të godinës projekti duhet të parashikojë veshjen termoizoluese të të gjithë fasadës veshëse të jashtme të godinës. Projekti arkitekturor duhet të mbajë në konsideratë përshtatjen e objektit për personat me aftësi të kufizuara të paktën për katin përdhe, referuar kategorizimeve të kufizimeve të ndryshme. Materialet e propozuara për të gjithë elementët ndarës dhe veshës, termoizolues, hidroizolues etj., duhet të jenë bashkëkohorë, të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe të shmangin elementët e rrezikshmërisë. Rëndësi duhet t'i kushtohet akustikës së ambienteve, izolimit nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës.

Gjatë të gjithë procesit të projektimit është e rëndësishme që të bashkëpunohet ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, pasi projekti arkitekturor duhet të reflektojë kërkesat e projektit strukturor, kërkesat e projekteve të sistemeve teknike, kërkesat e aspekteve arkitekturore të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kërkesat për efikasitetin energjetic, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe çdo kërkesë tjetër, të gjykuar si të nevojshme nga specialistët e përfshirë.

Stili arkitekturor

Stili arkitekturor duhet të respektojë funksionin e objektit si institucion publik, duke pasqyruar tendencat, frymën, teknikat dhe teknologjitë bashkëkohore. Stili i konceptimit të interiereve duhet të përputhet me funksionin e objektit. Ngjyra, estetika, stili dhe materialet e përdorur duhet të ndjekin të njëjtën linjë konceptuale, duke reflektuar edhe tendencat e kohës.

Rikonstruksion i plotë i objektit në përputhje me Standardin e Projektimit të Shkollave dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 12.04.2017, "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave", si dhe duke respektuar legjislacionin në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, si dhe rregulloret të zbatimit të tij, në fuqi, distancat nga objekti ekzistues, distancat nga kufiri i pronës, ose distancat ekzistuese përse kohë nuk ndryshon volumi i ndërtesës, si dhe distancat nga aksi i rrugës në përfundim duke krijuar kështu hapësirat e nevojshme për lëvizjen e këmbësorëve, makinave, etj.

Godina do të jetë ekzistuese 3 kate, duke përmirësuar kushtet sipas standardeve për ambientet e mësimdhënies, administratës, higjieno-sanitare, rekreacionit dhe logjistikës.

- Do të ribëhet hidroizolimi i tarracës;
- Do të vendosen të reja ulluket vertikale dhe sistemimi i ujrave të shiut, duke u maskuar në fasadë;
- Do të prishen të gjitha suvatimet brenda dhe do të ribëhen të reja, me suva 0.1;
- Do të prishen të gjitha shtresat e pllakave dhe do të bëhet shtrimi i tyre me pllaka gres porcelanate; me cilësi të parë, të parrëshqitshme;
- Shkallët do të rehabilitohen me veshje mermeri dhe rikonceptim të parapetit, duke përmirësuar dhe harmonizuar pjesën funksionale, pa rrezikshmëri në lëvizje apo rrëshqitje, si dhe me sinjalistikë identifikuese lehtësisht e dallueshme nga ana vizuale;
- Suvatimi i jashtëm do të bëet me sistem kapote dhe me grafiato 01, lyster me boje hidroplastike, ose zgjedhje të tjera arkitektonike me fasadë të ventuiluar apo më inovative, në harmoni me trajtimin estetik të interierit dhe eksterierit sipas standardeve për efikasitetin e energjisë.

- Dritaret do të kenë davancal mermeri me frezim për puthitjen e plotë të vetratave në konture për hidroizolim e plotë me ambientin e jashtë;
- Dritaret dhe dyert që janë në kontakt me ambientin e jashtëm do të jenë prej duralumini, dopio xham. Xhami që është në kontakt me ambientin e jashtëm duhet të jetë termik dhe me transparencë;
- Fasada e shkollës, të jetë e tillë që të mirëmbahet lehtë, të evitohen sipërfaqet e mëdha të xhamit atje ku është e mundur, kurse ngjyrat e fasadës të jenë të bukura, në mënyrë që objekti të bëhet më atraktive për nxënësit. Fasadat duhet të jenë të veshura me kapotë termike, apo zgjidhje të tjera më të avancuara për izolim termik dhe antizjarr. Konsulenti duhet të përcaktojë gjithashtu vendndodhjen e tabelës me emrin e shkollës.
- Dyert e jashtme që janë në katin përdhe do të jenë dyer të izoluara dhe rezistente ndaj goditjeve apo dëmtimeve në rast ushtrimi force;
- Dritaret e katit përdhe do të jenë me elementë mbrojtës metalike (psh. kangjella);
- Muret e brendshëm do të lyhen me hidromat, tavanet me hidromat, kurse pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me bojë akrilik me ngjyrë të ndryshme, ose jo nga muret, me bojë antialergjike, gjë e cila do të vendoset nga projektuesi;
- Instalimet elektrike do të behen të reja;
- Në të gjitha banjot do të shtohen kasetat e shkarkimit dhe përbën avantazh zgjidhja arkitektonike për kursimin e konsumit të ujit në mishelatorë dhe shkarkues wc;
- Kushtet higjieno-sanitare për tualetet e vajzave duhet të ofrojnë parametrat për kujdes personal gjatë periudhës së ciklit menstrual (ujë të ngrohtë, shataff, etj);
- E gjithë infrastruktura e internetit, energjisë elektrike, telefonisë, apo shërbime të tjera të nevojshme si rrjeti i kamerave, duhet të jetë i fshehur në mur dhe tavane të varur me kartonxhez, ku të mos shfaqet rrezikshmëri dhe mundësi dëmtimi gjatë përdorimit të ambienteve;
- Është parashikuar dhe sistemi qendror ngrohjes për të gjithë shkollën me ambientet ndihmëse;
- Sipas orientimit natyral të ndërtesës të zgjidhet hijëzimi sipas nevojës, apo shtimi i ndriçimit artificial në interior për të plotësuar kapacitetin homogjen të nevojshëm për mësimdhënie;
- Të zgjidhet vendosja e shkallëve të emergjencës dhe kafazi metalik rrethues me një zgjidhje estetike harmonizuese me fasadën;
- Përbën avantazh propozimi i një sistemi teknologjik dhe promjedisor për fasadën dhe sistemimin e jashtëm të terrenit të shkollës (gjelbërim, hijëzim, instalacione harmonike, ritmika, etj).

Kati përdhe

Kati përdhe i cili ka një sipërfaqe 698 m². Shkallët janë të gjera e plotësojnë parametrat për objekte arsimore të këtij karakteri.




Figura 10. Planimetri e katit përdhe

Gjithashtu, në këtë kat duhet organizuar aksesin për hyrjen dhe klasat të dedikuara për nxënësit, apo persona me aftësi të kufizuara PAK, një higjieno-sanitare edhe për persona me aftësi të kufizuara PAK, klasat, laboratorë, dhomat e zhveshjes, nyjet sanitare për meshkuj-femra, si dhe ambiente të tjera të nevojshme.

Kati i parë




Figura 11. Planimetri e katit të parë

Kati i dytë




Figura 12. Planimetri e katit të dytë

2.3.4 Kërkesat teknike kundrejt projektit konstruktiv

Hartimi i projektit konstruktiv duhet të mbajë në konsideratë propozimin e zgjidhjeve më të përshtatshme, referuar konceptit të përgjithshëm arkitekturor dhe funksionit të ambientit.

Materialet, teknikat dhe teknologjitë e propozuara duhet të respektojnë kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në mungesë të tyre projektuesi duhet t'u referohet Eurokodeve aktuale në përdorim.

Projekti konstruktiv duhet të respektojë kërkesat e jetëgjatësisë së projektimit, ngarkesave dhe rregullave të projektimit për sa i përket durabilitetit (Klasa e durabilitetit), në funksion të kushteve të ekspozimit të tij, bazuar në Eurokode.

2.3.4.1 Themelet

Kusht themelor dhe detyrë parësore teknike është verifikimi i themeleve të godinës ekzistuese si dhe përlllogaritja paraprake e aftësisë mbajtëse të tyre. Këtu përfshihet lloji i materialit me të cilin janë realizuar, përmasat, modalitetet e realizimit të tyre.

Në varësi të gjithë këtyre parametrave, të vetive fiziko-mekanike si dhe të thellësisë së tyre, konsulenti duhet të përcaktojë të gjitha mënyrat dhe mundësitë e ndërhyrjes në të në rast se vlerësohet e nevojshme.

2.3.4.2 Tarraca

Projektuesi duhet të japë të gjitha detajet për shtresat e hidroizolimit dhe vendosjen e kasetës së shkarkimit dhe ullukët vertikalë, si dhe detaje të tjera të domosdoshme për zbatimin e punimeve duke qenë se një pjesë e ujërave të shiut janë të pasistemuar dhe grumbullohen në ambientet e shkollës. Gjithashtu duhet të tregojë, numrin e ulluqeve dhe diametrat e tyre sipas normave në fuqi. Për sasi të reshjeve do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik.

2.3.4.3 Soletat

Është detyrë e konsulentit, kontrolli dhe verifikimi teknik i soletave ekzistuese të objektit, në mënyrë që të parashikohet rikonstruksioni i tyre sidomos në rastet kur ka probleme, të lidhura me degradimin e tyre dhe me uljen e aftësive mbajtëse.

Ky lloj kontrolli është akoma më i domosdoshëm në rastin e tavanit të varur në katin e parë i cili është pjesërisht i shkatërruar dhe në disa klasa për arsye sigurie nuk zhvillohet mësim.

2.3.4.4 Muret

Konsulenti do të japë të gjitha detajet e përforcimit të muraturës mbajtëse në rastin kur ajo paraqitet me probleme.

2.3.4.5 Suvatimet

Objekti i rikonstruktuar duhet të suvatohet nga brenda dhe jashtë. Në pjesët e dëmtuara, suvatimet e mureve dhe tavaneve do të kryhen në të gjithë sipërfaqen përkatëse duke ruajtur shtresën e parë ekzistuese ku të mundet në mure, kurse tavanet të pastrohen dhe të risuvatohen. Të gjitha shtresat e tjera në rast se janë të dëmtuara do të hiqen pa dëmtuar muret.

Përsa i përket suvatimeve të jashtme do të jenë në varësi të llojit të ndërhyrjes që parashikon projekti, nëse do të restaurohet sipërfaqja ekzistuese, ose do të rishikohet e gjitha sipas konceptit të ri që kërkon fasada duke marrë në konsideratë dhe kushtet për efikasitetin e energjisë në ndërtesa.

2.3.4.6 Lyerja e mureve të brendshëm dhe të jashtëm

Muret e brendshëm do të lyhen me hidromat, tavanet me hidromat, kurse pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me bojë akrilik me ngjyrë të ndryshme ose jo nga muret, bojë antialergjike, gjë e cila do të vendoset në bashkëpunim me stafin e shkollës.

2.3.4.7 Fasada

Fasada e shkollës, të jetë e tillë që të mirëmbahet lehtë, të evitohen sipërfaqet e mëdha të xhamit atje ku është e mundur, kurse ngjyrat e fasadës të jenë të bukura, në mënyrë që objekti të bëhet më atraktive për nxënësit. Fasadat duhet të jenë të veshura me kapotë termike, apo zgjidhje të tjera më të avancuara për izolim termik dhe antizjarr. Konsulenti duhet të përcaktojë gjithashtu vendndodhjen e tabelës me emrin e shkollës.

2.3.4.8 Shtresat e pllakave

Pllakat ekzistuese të dyshemesë së vjetër së bashku me llaçin e vjetër nëse është e nevojshme do të zëvendësohen nga shtresa e re e dyshemesë, me pllaka, duke patur parasysh rinivelimin e saj me llaç – çimento si dhe me shtresat e nevojshme izoluese në rastin e ambienteve që nevojiten. Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izoloohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specifikimet përkatëse.

2.3.4.9 Shkallët

Është e nevojshme përcaktimi i qartë i gjendjes së shkallëve, si nga ana funksionale në lidhje me kapacitetin ashtu edhe nga pikëpamja konstruktive. Edhe nëse shkallët nuk kanë nevojë për rikonstruksion, bazamakët dhe parapetet duhet të ribëhen.

Projekti duhet të përmbajë të gjitha detajet si dhe specifikimet teknike të domosdoshme për fazën e projekt zbatimit.

2.3.4.10 Dyer, dritare

Projektuesi duhet të përcaktojë që materialet që do të përdoren të jenë të cilësisë së lartë. Nëse janë propozuar dyer prej druri, ato duhet të jenë prej druri të fortë me mentesha të forta (minimumi tre për çdo derë) dhe sipas standardeve të MAS.

Dritaret dhe dyert që janë në kontakt me ambientin e jashtëm do të jenë prej duralumini, me dopio xham, me një xham termik në pjesën që ka kontakt me ambientin jashtë.

Vendosja e dyerve dhe plani i hapjes së tyre të realizohet i tillë që të plotësojë kushtet e daljes së shpejtë në raste emergjencash (me hapje nga korridori) dhe standardet e vendosura nga MAS.

Përsa i përket dritareve do të jenë duralumini të cilësisë së lartë me hapje me rrotullim dopio-xham dhe me sopralluce në ambiente që e kërkojnë atë. Gjithashtu për katet e para duhet të jetë të parashikuara të gjitha normat e sigurisë, pra edhe pajisja e tyre me elementet metalike mbrojtës përkatës.

2.3.4.11 Kalimet e emergjencës, shkallët, korridoret

Konsulenti duhet të parashikojë dhe kalimet e emergjencës (shkallët, korridoret). Numri dhe gjerësia e kalimeve të emergjencës duhet të sigurojnë largimin sa më të shpejtë dhe shfrytëzimi i tyre të nxjerrë në vend të sigurt jashtë ndërtesës me një rrugë të shkurtër, të shpejtë dhe pa rrezik.

Për përcaktimin e gjerësisë dhe gjatësisë së rrugëve të emergjencës, faktori kryesor është kohëzgjatja e largimit të personave nga objekti. Koha maksimale e largimit nga objekti në sekonda për çdo dhomë, mbas dhënies së sinjalit të alarmit duhet të jepet e llogaritur nga projektuesi.

Materiali për planet e evakuimit në rast emergjencash do të merren nga Bashkia Elbasan.

2.3.4.12 Ambientet sanitare

Në bashkëpunim me stafin mësimor, konsulenti duhet të parashikojë ambiente higjieno- sanitare të përshtatshme për nxënësit e grupmoshës, 6 deri 15 vjeç.

Nyjet sanitare të jenë të veçanta dhe lavamanët të jenë të mjaftueshëm për numrin e nxënësve. Të sigurohet ujë i vazhdueshëm dhe i ngrohtë në lavamanë, për këtë arsye të shikohet mundësia e instalimit të boliereve, si dhe realizimi i rrjetit të nevojshëm hidraulik në rast se vlerësohet e nevojshme.

Banja dhe parabanja të jenë të ajrosura, të ndriçuara dhe të ventiluar. Në rast se s'ka ajrim direkt duhet të pajisen me impiant ajrimi dhe ventilimi. Kollonat e shkarkimit të jenë të shkëputura nga kanalet e ventilimit, me ajrim të jashtëm dhe shkarkimet të jenë të kontrollueshme.

Banjat të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja dhe të përjashtohet hapja nga brenda, për raste emergjence.

Për katin përdhe duhet të ofrohen sipas standardeve kushte për akses në nyjet higjeno-sanitare për personat me aftësi të kufizuara (PAK).

2.3.4.13 Ambientet sportive

Për terrenet e jashtme sportive ka nevojë për ndërtimin e sistemit të drenazhimit, pasi në periudhat e reshjeve këto ambiente bëhen me baltë, sepse është tokë natyrore, pa kushtet e duhura për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik. Terrenet e jashtme sportive kanë nevojë për sistemim.

2.3.4.14 Sistemimet e jashtme dhe ambientet e gjelbëruara

Sistemimit të oborrit të shkollës duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë. Ai duhet të rezultojë me rrethim transparent (kangjella, etj) dhe të garantojë të gjitha normat e sigurisë dhe standardeve për ndërtime të këtij lloji. Ambientet e jashtme janë ambiente që kryesisht shërbejnë për qëndrim, çlodhje prandaj rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i një sipërfaqeje të gjelbër dhe me pemë. Projektuesi duhet të japë të detajuara shtresat përkatëse dhe teknologjinë e zbatimit të tyre, dhe të kombinojë ambientet e qëndrimit/rreshtimit me ambientet e gjelbëruara.

Konsulenti duhet t'i jap rëndësi dhe të parashikojë dhe ndriçimin e jashtëm të objektit, në përputhje me planin e zhvillimit të territorit të kësaj zone dhe në përputhje me kërkesat e veçanta për rrjetin e ndriçimit të dhënë në këtë detyrë projektimi.

Për të mbajtur pastërtinë e oborrit të shkollës, në projekt/preventiv të parashikohet vendosja e koshave për mbeturinat, sidomos në afërsi të stolave.

T'i kushtohet kujdes i veçantë, sistemimit dhe disiplinimit të ujërave sipërfaqësore të cilat janë problematike për këtë objekt.

2.3.5 Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të merren parasysh sa më poshtë:

- Të merret në konsideratë perspektiva 10-vjeçare e rritjes së numrit të fëmijëve për kapacitetin maksimal të shkollës. Të merret në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonave ku ndodhen objektet, por gjithashtu konsulenti duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona, nëse ka.
- Drejtimi i zhvillimit të territorit të zonës do të merret në Bashki.

Sistemi i largimit të ujërave të bardha dhe të zeza do të jetë mik.

Në përputhje me normat, konsulenti duhet të ketë parasysh numrin e fëmijëve, stafin mësimor dhe administrativ.

Konsulenti duhet të verifikojë gjendjen teknike të nyjeve higjeno-sanitare ekzistuese dhe duhet të përgatisë projektin e detajuar si për rikonstruksionin e atyre ekzistuese ashtu edhe të shtesës eventuale të kapacitetit (numrit) të tyre.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkëkohore dhe në përputhje me standardet në fuqi.

Rrjeti i amortizuar i ujësjellësit do të zëvendësohet. Gjithashtu në bashkëpunim me shoqërinë e Ujësjellës Kanalizime Elbasan do saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit ekzistues të zonës, si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës.

Materialet që do përdoren për rrjetin e brendshëm të ujësjellësit do jenë tuba polietileni me densitet të lartë për ujë të pijshëm me diametër dhe aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Për nyjen e marrjes nga rrjeti i zonës do të parashikohet puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Nëse është e domosdoshme, projektuesi duhet të parashikojë zëvendësimin dhe nxjerrjen jashtë pune të sistemit të vjetër të furnizimit me ujë.

Projektuesi të parashikojë në projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë nga pika e marrjes së dhënë nga Ujësjellës Kanalizime Elbasan deri tek matësi i ujit.

Të parashikohet realizimi i depozitave të ujit, të nevojshme në raste emergjence, si dhe lidhja e tyre në, me të paktën dy prej lavamanëve dhe nyjeve sanitareve si dhe depozitat e ujit për MNZ.

2.3.6 Rrjeti elektrik, telefonik dhe kompjuterik

Rikonstruksioni i objekteve duhet të përfshijë edhe instalimin e ri elektrik, telefonik dhe vlerësimin në rast se nevojitet për përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit të internetit në laboratorin e informatikës dhe zyrave të administratës.

Konsulenti duhet të parashikojë ndriçimin e ambienteve me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre. Projektuesi duhet të japë detajin e fiksimit të ndriçuesve si dhe dimensionet e elementeve në të cilat ato do të kapen.

Panelet e komandimit të vendosen të rinj sipas standardeve bashkëkohore.

Në këto kushte projektuesi duhet të parashikojë nëqoftëse nevojitet dhe instalimin e rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionim normal të sistemit elektrik me të gjitha pajisjet e saj. Projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e matësit elektrik trefazor, dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kabllit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar.

Pozicionimi i ndriçuesve për secilin ambient duhet të përputhet me konceptin arkitekturor të përgjithshëm, në përputhje me funksionin e ambientit dhe standardet kundrejt tij.

Ndriçuesit e propozuar duhet të shmangin elementët e rrezikshmërisë, emetimin e lëndëve të rrezikshme për shëndetin, përdorimin materialeve që shkaktojnë mbetje të dëmshme për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve, duke ofruar dhe konsum energjie ekonomik me llampa LED.

Ndriçimi në ambiente duhet të jetë shlodhës dhe plotësojë normativat e detyrueshme nga tipologjia funksionale e tyre. Shpërndarja e ndriçuesve në ambient duhet të përshtatet me kërkesat funksionale të tij, duke ruajtur sipas rastit një shpërndarje të njëtrajtshme të dritës. Kjo zgjidhje duhet gjithsesi të përmbushë kërkesat nominale të ambientit për ndriçim, sipas tipologjisë, pa cënuar konceptin e përgjithshëm të pasqyruar në projektin arkitekturor mbi estetikën, zgjidhjen e tavanëve, mureve dhe hapsirave të punës dhe ndriçimin e përgjithshëm të interierit. Tipologjia, estetika, këndi i hedhjes së dritës dhe gjeometria e secilit ndriçues duhet të përcaktohet në bashkëpunim me projektuesin arkitekt duke mbajtur në konsideratë lartësinë e ambientit dhe tavanëve të varur (në rast se janë propozuar). Drita ideale duhet të vijë në tavolinën e punës me kënd anësor dhe jo pingul. Shkëlqimi i sipërfaqeve duhet të kufizohet.

Pavarësisht referencave më sipër, nisur nga specifikat e veçanta të secilit ambient funksional, mbetet në gjykimin e projektuesit përdorimi i një standardi minimal ndriçimi, ose një tjetri, bazuar në kërkesat e saktësuara për secilin ambient, në përputhje me veprimtarinë dhe proceset e punës, për të cilët është projektuar.

Vendosja e prizave elektrike, Lan, sistemeve audio video etj. duhet të përputhet me hapësirat e punës të propozuara nga arkitekti në projektin e mobilimit.

Në tërësi në hartimin e projektit do të mbahen parasysh këto kërkesa për projektimin dhe zbatimin e rrjetit elektrik dhe elektronik:

- Të gjithë instalimet elektrike, kabllot dhe ndriçuesit, çelësat, prizat etj. duhet të jenë hermetikë.
- Ndriçimi elektrik duhet të zbatohet sipas normat e CE.
- Sistemi elektronik duhet të konceptohet me server (servera) qendror të veçantë.
- Në projektin elektrik duhet të parashikohet edhe instalimi i ndriçimit të emergjencës, në rastet e shpërthimeve të rrymës, apo emergjence të çfarëdo lloji.
- Në ndërtesë duhet të parashikohen sisteme elektrike dhe elektronike të nevojshme për mirëfunksionimin e ndërtesës. Krahas sa më sipër, të shqyrtohet **mundësia e integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë**.
- Projekti elektrik të jetë i shoqëruar me licencën e inxhinierit elektrik. Në projekt-preventiv duhet të parashikohen edhe llambat me bateri të karikueshme, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.
- Projekti duhet të përmajë rrjetin e ndriçimit, ku përfshihet edhe ndriçimi i ambienteve të jashtëm dhe ndriçimi i emergjencës, rrjetin e prizave të furnizimit me energji, të prizave të UPS, rrjetin e furnizimit me energji elektrike nga OSHEE, sistemin e telefonisë, rrjetit LAN, sinjalizimit të zjarrit, sistemin video, acces-control, sistemin e vëzhgimit me kamera, sistemin e rrufeprirjes etj., në harmoni me kërkesat e projektit arkitekturor.

2.3.7 Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë

Dhoma e transformatorit duhet të jetë e izoluar nga dhomat e tjera me mur zjarrdurrues dhe nuk duhet të ketë lidhje me kalimet e emergjencës.

I gjithë sistemi elektrik duhet të jetë i tillë që të stakohet në një pikë të vetme në katin përdhe, e cila mund të arrihet lehtë dhe të ketë shenjat dalluese përkatëse. Skema elektrike e ndriçimit dhe e fuqisë duhet të jetë e afishuar në panelin e stakimit.

Nuk lejohet që tubacionet e sistemeve të tjera (ngrohjes, ujit të ngrohtë etj) të vendosen në të njëjtin kanal.

Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni. Ndriçimi i emergjencës dhe i sigurisë duhet të vendoset në ambientet e mëposhtme:

- *Korridore, të cilat shërbejnë edhe si rrugë largimi emergjence;*
- *Në shkallë deri në largimin nga objekti;*
- *Dhoma që shërbejnë si salla mbledhjesh;*
- *Në ambientet që nuk kanë dritare;*
- *Në të gjitha dhomat e furnizimit me energji (gas, elektricitet etj).*

2.3.8 Sistemi i mbrojtjes atmosferike

Shkollat duhet patjetër të kenë sistemin e mbrojtjes atmosferike pasi Shqipëria gjendet në një zonë me shkarkime atmosferike të shumta.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike duhet të bëhet duke u bazuar në kushtet teknike të përcaktuara dhe në specifikimet e materialeve të ndërtimit.

2.3.9 Sistemi ngrohës dhe i ventilimit

Konsulenti duhet të parashikojë ndërtimin e plotë të sistemit ngrohës (ngrohje qendrore) duke argumentuar nga ana tekniko – ekonomike zgjedhjen e mënyrës së ngrohjes, por njëkohësisht projekti të sigurojë ventilimin e ambienteve.

Projektuesi duhet të parashikojë instalimin e rrjetit elektrik me fuqi të tillë (tre fazor) që të sigurojë funksionim normal të sistemit të ngrohjes.

Konsulenti të shikojë mundësinë për ndërtimin e një ambienti teknik të veçantë ku të instalohet kaldaja, grupi i pompave, rezervuarët e ujit sanitar dhe ujit për MNZ-në.

Në projekt duhet të jepet qartë dhe e detajuar, vendndodhja e dhomës së kaldajës dhe karakteristikat e saj, vendodhja e rezervuarit të naftës/ambienti i depozitimit të peletit, të cilat duhet të jenë në pozicion të tillë që të furnizohen lehtë me lëndë djegëse, dimensionet dhe lloji i tubacioneve, kolektorëve, radiatorëve që do të përdoren, të gjitha llogaritjet e bëra si edhe detajet e nevojshme së bashku me specifikimet teknike përkatëse për fazën e projekt zbatimit.

Në dhomën e kaldajës të parashikohet një dritare e hapshme, ose grilë e cila do të shërbejë për ajrimin e dhomës nga gazrat e krijuara, si dhe të parashikohet ventilimi mekanik (aspirator) i tij dhe instalimi i një lavamani.

Në llogaritjet për kapacitetin e rezervuarit të naftës, konsulenti duhet të marrë në konsideratë se gjatë sezonit të dimrit furnizimi nga Bashkia kryhet *dy deri në tre herë* me lëndë djegëse. Në rastin e

sistemit të ngrohjes me peletë, projektuesi duhet të parashikojë ambientin e depozitimit të lëndës djegëse të tillë që të sigurojë një nivel lagështie jo më shumë se 10 %.

2.3.10 Sistemi i mbrojtjes nga zjarrit (MNZ)

Konsulenti duhet të paraqesë dhe projektin e mbrojtjes nga zjarri, si dhe rregullat e sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standardeve evropiane.

Kërkohet të zgjidhet me mundësinë për vendosjen e shkallëve të emergjencës dhe kafaz metalik rrethues.

Sistemi i lajmërimit për zjarrin

Në objekt të shikohet mundësia e një kabinë telefonike që të mund të përdoret në çdo moment. Numrat e telefonit të zjarrfikësit duhet të jenë të afishuar dukshëm në këtë kabinë.

Ndërtesa duhet të ketë gjithashtu sistemin e brendshëm të alarmit, nëpërmjet të cilit në rast rreziku të bëhet largimi nga ndërtesa.

Sinjali i alarmit duhet të transmetohet në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jetë i qartë dhe i kuptueshëm nga të gjithë. Sistemi i alarmit duhet të futet në punë pavarësisht nga furnizimi me energji elektrike i objektit.

Sinjalizuesit e tymit

Këto do të veprojnë në mënyrë që të mbajnë ekuilibrin ndërmjet dhomës së hapur dhe të mbyllur, kështu kur tymi depërton në dhomën e hapur ai do të ketë kontakt me qarkun dhe do të aktivizojë sinjalin.

Të gjithë sinjalizuesit e tymit, të jenë instaluar të tilla që të mund të ndërrohen me zëvendësues.

Bombulat fikëse të zjarrit

Bombulat fikëse (me shkumë ose pluhur) duhet të vendosen në korridore dhe në ambientin teknik.

2.3.11 Raporti dhe auditimi i efikasitetit energjetik

Mbështetur në VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 (hyrja në fuqi 21.05.2015) "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e azhurnuar, pjesë e dokumentacionit për marrjen e Lejes së Ndërtimit duhet të jetë edhe projekti i efikasitetit energjetik, në rastet kur është e detyrueshme me ligj.

Pjesë e dokumentacionit të projektimit duhet të jetë edhe Raporti mbi efikasitetin e energjetik të ndërhyrjes së propozuar. Projekti i propozuar dhe specifikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për efikasitetin e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

Kur projektohet një ndërtesë e re ose kur një ndërtesë duhet t'i nënshtrohet një rinovimi të rëndësishëm, subjekti që ka apo do të ketë në pronësi apo përgjegjësi administrimi këtë ndërtesë, duhet të marrë në konsideratë zbatimin e kërkesave të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë së ndërtesave dhe të analizojë mundësinë e përdorimit të sistemeve me një

performancë të lartë të energjisë, të parashikuara ne Ligjin 116/2016 “PËR PERFORMANCËN E ENERGIJISË SË NDËRTESAVE” neni 8 e vijues.

Hartimi i propozimeve të zgjidhjeve teknike në respektim të kriterëve të efikasitetit energjetic të ndërtesës së parashikura, duhet të kryhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet të gjithë specialistëve të përfshirë, me qëllim që në të gjithë projektet specifike të mbahen në konsideratë kriteret e efikasitetit energjetic, për arritjen e një performancë sa më të mirë energjeticë të të gjithë ndërtesës.

Hartimi i Raportit të efikasitetit energjetic duhet të kryhet në përputhje me metodologjinë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa, sipas nenit 5 të Ligjit 116/2016 më sipër cituar.

Gjatë procesit të projektimit duhet paraprakisht të kryhet vlerësimi i mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjie. Gjatë vlerësimit teknik të mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjie, duhet të merren në konsideratë çështjet mjedisore dhe ekonomike.

Projekti i propozuar dhe specififikimet teknike duhet të përmbushin kriteret për efikasitetin e energjisë, në përputhje me propozimet dhe masat e reflektuara në këtë raport.

2.3.12 Kërkesat teknike kundrejt shërbimit të VNM

Në rast nevojë referuar legjislacionit përkatës në fuqi, nga vlerësimi sipas ndërhyrjeve që ofron projektuesi, Raporti i VNM/VNM do të mundësohet nga Bashkia Elbasan.

- Kërkesa të veçanta

Në realizimin e projektit të rikonstruksionit, si dhe atij të mirëfillteë arkitektonik duhen patur parasysh dhe te gjejnë zbatimin e duhur të gjitha rregullat dhe normat urbanistike dhe arkitektonike për personat me aftësi të kufizuar PAK.

Projektuesi duhet të parashikojë në projekt/preventiv edhe rampat për lëvizjet e fëmijëve me aftësi të kufizuar (PAK), sinjalistika për të verbërit, etj.

- Projektuesi gjithashtu duhet të sigurojë azhurnimin e rrjeteve inxhinierike të infrastrukturës për objektin nga institucionet kompetente.
- Dokumentacioni ligjor që shoqëron dosjen e paraqitur për leje ndërtimi sipas formularëve përkatës, (përveç konfirmimit të pronësisë së objektit, azhurnimit topografik, pagesat për certifikatën e performancës së energjisë në Agjencinë e Efikasitetit të Energjisë, Oponencën Teknike në Institutin e Ndërtimit, kërkesat teknike kundrejt shërbimit të VNM, vlerësuar sipas ndërhyrjeve që ofron projekti) që do të sigurohen nga bashkia), do të përgatiten nga vetë projektuesi.

3. HARTIMI I PREVENTIVIT

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve në fuqi. Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do t'i bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efijencën e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas çmimeve të V.K.M nr. 616, datë 13.04.2023.

4. STANDARDET

4.1 Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

4.2 Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji "Për planifikimin e territorit".

5. REALIZIMI I PROJEKTIT

Projekti i paraqitur për Rikonstruksionin e Shkollës "Vasil Kamami" duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 "Për Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Terriori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim" për dokumentacionin përkatës:

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit të objektit "Rikonstruksion i Shkollës Vasil Kamami" me përmbajtjen si më poshtë:

- *Raporti Teknik;*
- *Projektin arkitektonik: Relacion arkitektonik i objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i mbulesës, etj;*
- *Projektin e zbatimit/konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.*

- *Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve;*
- *Projekt Zbatimin e instalimeve elektrike, të shoqëruara me licencën e projektuesit;*
- *Projekt Zbatimin e instalimit të sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit;*
- *Projektin e sistemit dhe të gjelbërimit të oborrit, projektin e ambienteve të lojrave;*
- *Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;*
- *Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;*
- *Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren;*
- *Relacionin gjeologjik për shtesat e reja të parashikuara;*
- *Raportin e Ndikimit në Mjedis (vlerësuar në rast nevojë me Bashkinë sipas kriterëve për leje ndërtimi);*
- *Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut;*
- *Analizat teknike të çmimeve të zërave të punime që nuk janë në manual;*
- *Planin e organizimit të punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve që do jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur në grafikun e punimeve;*
- *Licencë të firmës projektuese, licencë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtar.*
- *Raporin e auditimit të energjisë për objektin e projektit teknik;*
- *Deklaratat e përgjegjësive profesionale për secilin ekspert kryesor (arkitekt, inxhinier konstruktor, inxhinier mekanik, auditues energjetik, inxhinier elektrik, etj) që nënshkruan projektin;*
- *Policat e sigurimit për secilin ekspert kryesor (arkitekt, inxhinier konstruktor, inxhinier mekanik, auditues energjetik, inxhinier elektrik, etj) që nënshkruan projektin.*

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet shkolla. Sistemin ekzistues të largimit të ujërave, Sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, Sistemin ndriçues rrugor, distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Elbasanit, seksioni i urbanistikës dhe nga kadastra e asetet.
- Konsulentit do t'i vihet në dispozicion edhe një Program Standard i ambienteve ku janë përcaktuar standardet minimale të organizimit të hapësirave të brendshme, lloji i ambienteve të detyrueshme, instruksione mbi funksionet që duhet të akomodohen, sipërfaqet funksionale të rrethimeve dhe sistemeve të jashtme, etj.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë:

- *Plani i vendosjes së strukturës i cili do të hartohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Projekteve dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit) pranë Bashkisë së Elbasanit.*
- *Licencë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të Regjistrit Tregtar.*
- *Licenca të inxhinierëve projektues, licenca të ekspertit mjedisor + deklarata noteriale të inxhinierëve projektues.*
- *Projekti i plotë elektrik (planvendosjen e të gjitha pajisjeve elektrike, sistemi data - telefoni, projekti i MNZ, i mbrojtjes atmosferike dhe tokëzimit) të printuara në formatin A3, shkalla 1:1000 në 4 kopje origjinale;*
- *Kopja e licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektin (në 4 kopje);*
- *Planvendosja e objektit në shkallën 1 : 1000 format A3 (kopje origjinale);*

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Elbasanit. Studio e licencuar (e pajisur me NIPT dhe QKB) për projektim duhet të ketë të punësuar të paktën 3 punonjës, ku një prej tyre të jetë arkitekt, dhe pjesa tjetër e specialistëve të nevojshëm për hartimin e projektit teknik mund të realizohet me ekspertë të jashtëm të dakordësuar mes tyre sipas legjislacionit përkatës.

Secili ekspert, pjesëtar i Grupit të Projektimit, duhet të ofrojë një shërbim profesional dhe të ketë kualifikimin e nevojshëm për kryerjen e këtij shërbimi. Për secilin ekspert do të paraqiten CV –të dhe licensat përkatëse.

Stafi që kërkohet duhet të mbulojë:

- Arkitekt;
- Inxhinier ndërtimi (i specializuar në fushën e projektimit të strukturave).
- Inxhinier ndërtimi (i profilit hidroteknik);
- Inxhinier për sistemet e ngrohjes;
- Inxhinier elektrik/elektronik.;
- Auditues energjetik.

Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

Për këtë fazë të punës, duhet të përgatitet dokumentacioni tekniko - ligjor përkatës, në përputhje me kërkesat ligjore, me qëllim plotësimin e dosjes për marrjen e lejes së ndërtimit, sipas tipologjive të lejeve. Përmbajtja e dosjes për leje ndërtimi përcaktohet nga legjislacioni në fuqi. Këtu përfshihet përgatitja e dosjes për projektin teknik, përgatitja e dosjes për kryerjen e oponencës teknike, dokumentacioni për marrjen e pëlqimit mjedisor në rast nevojë, dokumentacioni për marrjen e certifikatës së auditimit energjetik.

6. KOHËZGJATJA E KRYERJES SË SHËRBIMIT

Periudha e fillimit

Data e parashikuar e fillimit për ofrimin e shërbimeve do të jetë data e përcaktuar në kontratën e shërbimit.

Periudha e përfundimit e parashikuar, ose kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shërbimit do të përcaktohet në ditë kalendarike në kontratën mes palëve. Kjo kohëzgjatje shërbimesh është parashikuar për shërbimin e kërkuar. Kjo kohëzgjatje është parashikuar për përgatitjen e projektit sipas fazave dhe dokumenteve të kërkuara në pikën 5.

Duhet të theksohet se kohëzgjatja e përgjithshme e hartimit të projektit ka të bëjë me dorëzimin e dokumentacionit pranë Porositësit. Grupi i Projektimit duhet të jetë i gatshëm të angazhohet për plotësimin, dorëzimin dhe mbrojtjen e projektit sipas kërkesave të institucioneve lejuese, me qëllim marrjen e lejeve të nevojshme për zbatimin e tij.

Grupi i projektimit duhet të konsiderojë se takimi fillestar do të organizohet me pjesëmarrjen e ekipit projektues, grupit të hartimit të detyrës së projektimit dhe përfaqësuesve të përfituesve.

Drejtuuesi i ekipit të projektimit do të jetë përgjegjës për organizimin e takimeve dhe koordinimin e procesit të projektimit. Grupi i Projektimit duhet të paraqesë planin e punës për të siguruar përdorimin efikas të burimeve dhe për të përshatur kërkesat aktuale të punës me kërkesat paraprake.

7. RAPORTIMI

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe ku të paktën dy nga kopjet të jenë të printuara me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin "dwg" (AutoCad 2016-2022). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 2 CD).

- Të gjithë raportet do të dorëzohen në formë fizike dhe në formë elektronike pranë Porositësit, në format të lexueshme. Shkrimet dhe detajet të dallohen qartë.
- Vizatimet dhe raportet e projekt – preventivit të zbatimit duhet të jenë në 4 (katër) kopje origjinale të printuara dhe 2 (dy) CD me të gjitha materialet në formatet përkatëse (autocad, word, excel, etj.).
- Në CD duhet të bashkëlidhen edhe versionet "pdf" të të gjithë materialeve bashkë me nënshkrimin elektronik për çdo profil ekspertit sipas dokumentacionit të nevojshëm për aplikim për leje ndërtimi nga Bashkia Elbasan në sistemin "e-leje".
- Të gjithë dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga të gjithë anëtarët e ekipit të projektimit.

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- *Raportin teknik të projektimit arkitektonik;*
- *Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat që përfshin ndërhyrja (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.) si dhe masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e investitorit.*
- *Relacionin sizmologjik të truallit (kur nuk ka studim, një përshkrim i përgjithshëm);*
- *Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.*

Relacioni gjeologjik dhe vetitë fiziko-mekanike të dherave ku duhet të paraqiten.

- *Cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit ekzistues.*
- *Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.*

8. PARAQITJA E VIZATIMEVE

Vizatimet në fazë projekt zbatimi duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

1. *Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme*
2. *Planvendosja e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500*
3. *Planimetritë e kateve ekzistuese Shk. 1:100, 1:50*
4. *Planimetritë e objektit pas ndryshimeve Shk. 1:100; 1:50*
5. *Fasadat ekzistuese Shk.1:100*
6. *Fasadat e reja në 2D dhe 3D Shk.1:100*
7. *Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100*
8. *Planimetria e themeleve Shk.1:100*

9. *Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10*
10. *Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50*
11. *Planimetritë e mobilimit të shkollës Shk.1:100*
12. *Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkollën Shk. 1: 100*
13. *Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20*
14. *Planimetria e furnizimit me ujë në Shk. 1: 200, 1:100*
15. *Skemat aksonometrike të furnizimit me ujë, detaje të pajisjeve hidrosanitare Shk.1:100*
16. *Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10*
17. *Planimetria, aksonometria dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100*
18. *Planimetria dhe detaje të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100*
19. *Planimetria e dhomës së kaldajës, konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50*
20. *Planimetri dhe detaje për ndriçimin, fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50*
21. *Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objektin, Shk. 1:100*
22. *Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50*
23. *Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50*
24. *Planimetria e ambienteve sportive dhe ambienteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50*
25. *Planimetria e murit rrethues, tipin dhe detajin e fiksimit të stolave Shk.1:100; 1:50.*
26. *Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50.*

9. PREVENTIVI

Grupi i Projektimit duhet të paraqesë detyrimisht preventivin përfundimtar të punimeve. Çdo zë i këtij preventivi duhet të mbështetet në Klasifikimet Ligjore të Kostove dhe Analizat Teknike të Çmimeve nga Manualet Teknike përkatëse, në përputhje me VKM në fuqi (V.K.M nr. 616, datë 13.04.2023). Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale, të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut duke marrë tre oferta nga operatorë ekonomike, që operojnë në vendin tonë (oferta që do të bëhen pjesë e dokumentit të dorëzuar). Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndarë sipas kategorive dhe zërave të punës.

Harmonizimi dhe koordinimi i kategorive të punës së projektit të bëra nga specialistët e përfshirë në planifikimin e projektit, përfshirë fondin rezervë dhe T.V.Sh. 20 %.

10. INVESTIMI THEMELOR

Projekti teknik do të aprovohet nga Europartners Development si aplikues i grantit të UNICEF Albania për programin "Infrastruktura shkollore" dhe nga Bashkia e Elbasanit.

Duke marrë në konsideratë investime të ngjashme nga bashkia Elbasan, vlera e përllëgaritur paraprake për këtë investim për zbatim është rreth **134,777,000** (njëqind e tridhjetë e katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë (me TVSH).